



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJI**  
**PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW**  
**ON SOCIAL AND FAMILY SERVICES<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA**  
**O SOCIJALNIM I PORODIČNIM USLUGA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, është miratuar në mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.02/159 të datës 13.09.2023.

<sup>2</sup> Draft Law On Social And Family Services, was approved on the 156 and meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 02/159, dated 13.09.2023.

<sup>3</sup> Nacrt Zakona o Socijalnim i Porodičnim Usluga, u usvojen je na 159 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.02/159, datum 13.09.2023.

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ NR. XX PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE</b></p> <p><b>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Ky ligj rregullon shërbimet sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike dhe private që hartojnë politika dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.</p>	<p><b>Assembly of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Hereby approves:</p> <p><b>LAW NO. XX ON SOCIAL AND FAMILY SERVICES</b></p> <p><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>This law shall regulate social and family services for persons in need and families in need, duties and responsibilities of public and private institutions that draft policies and provide social and family services.</p>	<p><b>Skupština Republike Kosova,</b></p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON BR. XX O SOCIJALNIM I PORODIČNIM USLUGA</b></p> <p><b>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 1 Svrha</b></p> <p>Ovaj zakon reguliše socijalne i porodične usluge, za lica u potrebi i porodice koje su u potrebi, dužnosti i odgovornosti javnih i privatnih institucija koje izrađuju politike i pružaju socijalne i porodične usluge.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Dispozitat e këtij ligji zbatohen për institucionet publike dhe private, organizatat joqeveritare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale dhe familjare për të siguruar mirëqenien, kujdesin për dinjitetin dhe jetën e personave në nevojë në pajtim me legjisllacionin në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>The provisions of this law shall apply to public and private institutions, non-governmental organizations and other providers of social and family services to ensure the well-being, and care for the dignity and life of persons in need in accordance with the legislation in force.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p> <p>Određbe ovog zakona primenjuju se na javne i privatne institucije, nevladine organizacije i druge pružaocce socijalnih i porodičnih usluga radi obezbeđivanja dobrobit, negu o dostojanstvu i životu osoba u potrebi u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Shërbimet sociale</b> - shërbime që ofrohen përmes metodave të punës sociale dhe metodave tjera, me qëllim të rritjes së mirëqenies për individët, familjet e cenuara dhe komunitetin, të cilat ndihmojnë në eliminimin e rreziqeve, zvogëlimin e varfërisë, përmirësimin e përfshirjes dhe integritimit me qëllim të arritjes së potencialit të plotë në jetë.</p> <p>1.2. <b>Përkujdesja e drejtpërdrejtë sociale</b> - veprimtari e organizuar me interes publik për ofrimin e ndihmës</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. The terms used in this law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Social services</b> - services that are provided through social work methods and other methods, with the aim of increasing well-being for individuals, vulnerable families and the community, which help to eliminate risks, reduce poverty, improve inclusion and integration in order to reach one's full potential in life.</p> <p>1.2. <b>Direct social care</b> - activity organized in the public interest for the provision of assistance to individuals in</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Izrazi koji se koriste u ovom zakonu imaju ovo značenje:</p> <p>1.1. <b>Socijalne usluge</b> - usluge koje se pružaju kroz metode socijalnog rada i druge metode, sa ciljem povećanja dobrobita za pojedince, ugrožene porodice i zajednicu, koje pomažu u otklanjanju opasnosti, smanjenju siromaštva, unapređenju obuhvaćenja i integracije u cilju ostvarivanja potpunog potencijala u životu.</p> <p>1.2. <b>Neposredna socijalna zaštita</b> - delatnost organizovana u javnom interesu za pružanje pomoći osoba u</p>

<p>për individët në nevojë sociale, në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin dhe mbikëqyrjen, përkujdesje e cila mund t'i ofrohet në shtëpinë e vet personit, në një familje tjetër, në një qendër të specializuar të qëndrimit ditor, ose në një institucion rezidencial;</p> <p><b>1.3. Këshillimi profesional</b> - proces sistematik dhe i programuar i ofrimit të informacionit, këshillave dhe udhëzimeve me qëllim që të ndihmohet individi, familja, grupi dhe komuniteti për të përmirësuar rrethanat sociale dhe ndër njerëzore;</p> <p><b>1.4. Ndhma materiale</b> - sigurimi i parave, strehimit të përkohshëm, ushqimit, pagesës së shpenzimeve mjekësore, veshmbathjes ose çfarëdo nevojë tjetër të domosdoshme urgjente për individin ose familjen, të cilët nuk kanë burim tjetër në dispozicion;</p> <p><b>1.5. Person në nevojë</b> - cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale, pa u kufizuar dhe atë për shkak:</p>	<p>social need, in relation to household chores, personal care, mobility, communication and supervision, care which can be provided in the person's own home, in another family, in a specialized day care center, or in a residential institution;</p> <p><b>1.3. Professional counselling</b> - systematic and programmed process of providing information, advice and guidance in order to help the individual, family, group and community to improve social and interpersonal circumstances;</p> <p><b>1.4. Material assistance</b> - providing money, temporary shelter, food, payment of medical expenses, clothing or any other urgent need for the individual or family who have no other resources available;</p> <p><b>1.5. Person in need</b> - any person who is in the territory of the Republic of Kosovo, regardless of status or country of origin, who needs social services, without limitation, due to the following:</p>	<p>socijalnoj potrebi, u vezi sa kućnim poslovima, ličnom negom, mobilnošću, komunikacijom i nadzorom, nega koja se može pružiti u sopstvenom domu, u drugoj porodici, u specijalizovanom dnevnom boravku, ili u rezidencijalnoj instituciji;</p> <p><b>1.3. Stručno savetovanje</b> – sistematski i programirani proces pružanja informacija, saveta i savetovanja u cilju pomoći pojedincu, porodici, grupi i zajednici da poboljšaju društvene i međuljudske okolnosti;</p> <p><b>1.4. Materijalna pomoć</b> - obezbeđivanje novca, privremenog smeštaja, ishrane, plaćanje medicinskih troškova, odeće ili bilo koje druge hitne potrebe za pojedinca ili porodicu koji nemaju drugih sredstava na raspolaganju;</p> <p><b>1.5. Osoba u potrebi</b> - svako lice koje se nalazi na teritoriji Republike Kosovo, bez obzira na status ili zemlju porekla, kome su potrebne socijalne usluge, bez ograničenja, zbog:</p>
---	---	--

<p>1.5.1. se është fëmijë pa përkujdesje prindërore;</p> <p>1.5.2. se është fëmijë në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror;</p> <p>1.5.3. se është fëmijë me vështirësi në sjellje;</p> <p>1.5.4. se është viktimë e abuzimit dhe keqtrajtimit, përfshirë atë fizik, psikologjik, seksual dhe lënien pas dore;</p> <p>1.5.5. se është fëmijë në konflikt apo në kontakt me ligjin;</p> <p>1.5.6. të marrëdhënieve të çrregulluara në familje;</p> <p>1.5.7. të moshës së shtyer;</p> <p>1.5.8. të aftësisë së kufizuar fizike;</p> <p>1.5.9. të aftësisë së kufizuar mendore;</p> <p>1.5.10. të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi;</p> <p>1.5.11. të dhunës në familje dhe çfarëdo lloji tjetër dhune në bazë gjinore;</p>	<p>1.5.1. he/she is a child without parental care;</p> <p>1.5.2. he/she is a child at risk of losing parental care;</p> <p>1.5.3. he/she is a child with behavioral difficulties;</p> <p>1.5.4. he/she is a victim of abuse and mistreatment, including physical, psychological, sexual abuse and neglect;</p> <p>1.5.5. he/she is a child in conflict or in contact with the law;</p> <p>1.5.6. disordered relations in the family;</p> <p>1.5.7. a person of advanced age;</p> <p>1.5.8. a person with physical disability;</p> <p>1.5.9 a person with mental disability;</p> <p>1.5.10. risk of exploitation or abuse;</p> <p>1.5.11. domestic violence and any other type of gender-based violence;</p>	<p>1.5.1. da je dete bez roditeljskog staranja;</p> <p>1.5.2. da je dete u opasnosti od gubitka roditeljskog staranja;</p> <p>1.5.3. da je dete sa poteškoćama u ponašanju;</p> <p>1.5.4. da je žrtva zlostavljanja i maltretiranja, uključujući fizičko, psihičko, seksualno i zanemarivanje;</p> <p>1.5.5. da je dete u sukobu ili u kontaktu sa zakonom;</p> <p>1.5.6. poremećenih odnosa u porodici;</p> <p>1.5.7. starog uzrasta;</p> <p>1.5.8. ograničene fizičke sposobnosti;</p> <p>1.5.9. ograničene mentalne sposobnosti;</p> <p>1.5.10. opasnost od iskorišćenja ili zlostavljanja;</p> <p>1.5.11. nasilja u porodici i bilo koje druge vrste rodno zasnovanog nasilja;</p>
--	---	--

<p>1.5.12. të trafikimit me qenie njerëzore;</p> <p>1.5.13. të përfshirjes së fëmijëve në punë të rënda;</p> <p>1.5.14. të varësisë nga substancat psiko-aktive, siç janë: alkooli, drogat apo ndonjë lëndë tjetër natyrale apo farmaceutike që shkakton varësinë;</p> <p>1.5.15. të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu; ose</p> <p>1.5.16. të ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona në nevojë.</p> <p>1.6. <b>Familje në nevojë</b> - familja kur njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit i nevojitet ndihma, apo rastet kur kërkohet përkujdesja për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës;</p> <p>1.7. <b>Profesionist i shërbimeve sociale</b> – ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose të ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është licencuar dhe</p>	<p>1.5.12. human trafficking;</p> <p>1.5.13 engagement of children in hard labour;</p> <p>1.5.14. addiction to psychoactive substances, such as: alcohol, drugs or any other natural or pharmaceutical substance that causes addiction;</p> <p>1.5.15. emergencies or disasters caused by nature or man; OR</p> <p>1.5.16. any other reason that makes them persons in need.</p> <p>1.6. <b>Family in need</b> - family where one or both parents or guardians need assistance, or cases where care for the child is required due to their condition or the condition of the child.</p> <p>1.7. <b>Social services professional</b> – provider of social and family services with adequate qualification in the field of social work, psychology, sociology, law, pedagogy or any other field closely related to social and family services, who is licensed and registered in the Ministry's register, that provide social</p>	<p>1.5.12. trgovine ljudima;</p> <p>1.5.13 uključivanje dece u teške poslove;</p> <p>1.5.14. zavisnost od psihoaktivnih supstanci, kao što su: alkohol, droga ili bilo koja druga prirodna ili farmaceutska supstanca koja izaziva zavisnost;</p> <p>1.5.15. vanrednih situacija ili nepogoa izazvanih prirodom ili čovekom; ili</p> <p>1.5.16. iz bilo kog drugog razloga koji ih čini osobama u potrebi.</p> <p>1.6. <b>Porodica u potrebi</b> - porodica u kojoj je jednom ili oba roditelja ili staratelja potrebna pomoć, ili slučajevi kada je nega o detetu potrebna zbog njihovog stanja ili stanja deteta.</p> <p>1.7. <b>Stručnjak za socijalne usluge</b> – pružalac socijalnih i porodičnih usluga sa odgovarajućom stručnom spremom iz oblasti socijalnog rada, psihologije, sociologije, prava, pedagogije ili bilo koje druge oblasti usko povezane sa socijalnim i porodičnim uslugama, koji je licenciran i upisan u registar</p>
---	---	--

<p>regjistruar në regjistër të Ministrisë, që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare nga fusha e përgjegjësisë dhe kompetencës së tyre profesionale;</p> <p>1.8. <b>Ministria</b> - Ministria e Drejtësisë;</p> <p>1.9. <b>Komuna</b> - Kryeqyteti Prishtina dhe komunat në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.10. <b>Departamenti</b> - Departamenti përkatës në Ministri për Politika dhe Shërbime Sociale dhe Familjare;</p> <p>1.11. <b>Këshilli Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare</b> - mekanizimi për zhvillimin e programeve për trajnimin e vazhdueshëm profesional për ofruesit e shërbimeve sociale dhe licencimin e ofruesve individual për shërbime sociale dhe familjare.</p> <p>1.12. <b>Qendra për Punë Sociale</b> - institucion social administrativ dhe profesional i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale;</p> <p>1.13. <b>Organi i Kujdestarisë</b> - organi përgjegjës që vepron në kuadër të</p>	<p>and family services from the field of their responsibility and professional competence;</p> <p>1.8. <b>Ministry</b> – Ministry of Justice;</p> <p>1.9. <b>Municipality</b> – Capital Pristina and municipalities in the Republic of Kosovo.</p> <p>1.10. <b>Department</b> – The relevant Social and Family Services Department at the Ministry;</p> <p>1.11. <b>Professional Council for Social and Family Services</b> - mechanism for developing programs for continuous professional training for social service providers and licensing of individual providers for social and family services.</p> <p>1.12. <b>Center for Social Work</b> - administrative and professional social institution at the municipal level, competent for the protection of citizens in social need;</p> <p>1.13. <b>Guardianship Body</b> - the responsible body acting within the</p>	<p>Ministarstva, koji pružaju socijalne i porodične usluge iz oblasti njihove odgovornosti i stručne nadležnosti;</p> <p>1.8. <b>Ministarstvo</b> – Ministarstvo Pravde;</p> <p>1.9. <b>Opština</b> - Glavni grad i opštine u Republici Kosovo.</p> <p>1.10. <b>Odeljenje</b> – Relevantno odeljenje u Ministarstvu za politiku i socijalne usluge i porodica;</p> <p>1.11. <b>Stručno veće za socijalne i porodične usluge</b> – mehanizam za razvijanje programa za neposredno stručno usavršavanje za pružaoce usluga socijalne i licenciranje pojedinačnih pružalaca socijalnih i porodičnih usluga.</p> <p>1.12. <b>Centar za Socijalni Rad</b> – društvena institucija administrativnog i stručnog nivoa opštinski, nadležan za zaštitu građana u stanju socijalne potrebe;</p> <p>1.13. <b>Organ starateljstva</b> - odgovorni organ koji deluje u okviru Centra za</p>
--	---	--

<p>Qendrës për Punë Sociale, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë;</p> <p>1.14. <b>Menaxheri i Rastit</b> - zyrtari përgjegjës i caktuar nga Organi i Kujdestarisë, për menaxhimin e rastit, i cili në bashkëpunim me akterët relevant vlerëson nevojat e përfituesit dhe harton planin e përkujdesjes;</p> <p>1.15. <b>Kujdestari Ligjor</b> - personi i caktuar me vendim të Organit të Kujdestarisë, i cili ka për obligim t'i përfaqësoj në mënyrë ligjore të drejtat dhe interesat e personit nën kujdestari.</p> <p>1.16. <b>Paneli për Adoptim</b> - nënkupton trupën profesionale të themeluar nga Ministria për mbarëvajtjen dhe monitorimin e procesit të adoptimit vendor dhe ndërkombëtar;</p> <p>1.17. <b>Paneli për Strehim Familjar</b> - trup profesionale i cili jep pëlqimin për vendosjen e fëmijës apo personit të rritur në strehim familjar brenda apo jashtë rrethit familjar, bazuar në vlerësimin e Organit të Kujdestarisë, të</p>	<p>Center for Social Work which is responsible for protecting the interests of children and adults, consisting of a group of experts with professional experience in the specific area of responsibility.</p> <p>1.14. <b>Case Manager</b> - the responsible official appointed by the Guardianship Body, for case management, who, in cooperation with the relevant actors, assesses the needs of the beneficiary and draws up the care plan;</p> <p>1.15. <b>Legal Guardian</b> - the person appointed by the decision of the Guardianship Body, who has the obligation to legally represent the rights and interests of the person under guardianship.</p> <p>1.16. <b>Adoption Panel</b> – means the professional body established by the Ministry for the smooth running and monitoring of the local and international adoption process;</p> <p>1.17. <b>Foster Care Panel</b> - professional body which consents to the placement of a child or an adult with a foster family inside or outside the family circle, based on the assessment of the Guardianship Body, who are provided with housing</p>	<p>Socijalni rad, koji je zadužen za zaštitu interesa dece i odraslih, sastavljen od grupe stručnjaka sa profesionalnim iskustvom u posebnoj oblasti odgovornost.</p> <p>1.14. <b>Rukovodilac predmeta</b> - odgovorni službenik kojeg imenuje organ starateljstva, za upravljanje predmetom, koji u saradnji sa relevantnim akterima procenjuje potrebe korisnika i izradi plan nege;</p> <p>1.15. <b>Zakonski staratelj</b> - lice imenovano odlukom organa starateljstva koje ima za obavezu zakonskog zastupanja prava i interesa osoba pod starateljstvo.</p> <p>1.16. <b>Stručni savet za usvojenje</b> – je stručni organ koji osniva Ministarstvo znanapredak i praćenje lokalnog i međunarodnog procesa usvojenja;</p> <p>1.17. <b>Panel za porodično smeštanje</b> - stručni organ koji daje saglasnost za smeštaj deteta ili odrasle osebe u porodično smeštanje unutar ili van okruženja porodice, na osnovu procene organa starateljstva, kojima je</p>
--	--	--



<p>cilëve i'u sigurohet strehimi dhe përkujdesja nëpërmjet ofrimit të shërbimit social në rrethin familjar të familjes biologjike apo jashtë rrethit familjar të familjes biologjike;</p> <p><b>1.18. Paneli për strehim rezidencial</b> - trup profesionale në nivel qendror dhe lokal i cili jep pëlqimin për vendosjen e fëmijës, personit të rritur dhe të moshuar, në strehim rezidencial, bazuar në vlerësimin e Organit të Kujdestarisë, të cilëve i'u sigurohet strehimi dhe përkujdesja, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sociale;</p> <p><b>1.19. Fëmijë</b> - personi deri në moshën 18 vjeç;</p> <p><b>1.20. I mitur</b> - personi në mes të moshës 14 - 18 vjeç;</p> <p><b>1.21. Madhor</b> - personi që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;</p> <p><b>1.22. Të rinj</b> - personat deri sa të mbushin moshën 24 vjeç;</p> <p><b>1.23. Organizatat e shoqërisë civile</b> - organizata të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;</p>	<p>and care through the provision of social services in the family circle of the biological family or outside the family circle of the biological family;</p> <p><b>1.18. Residential Care Panel</b> - professional body at the central and local level which gives consent for the placement of the child, adult and elderly person in residential care, based on the assessment of the Guardianship Body, who are provided with housing and care, through the provision of social services;</p> <p><b>1.19. Child</b> - a person up to the age of 18;</p> <p><b>1.20. Minor</b> - a person between the ages of 14 - 18 years;</p> <p><b>1.21. Adult</b> - a person who has reached the age of eighteen (18);</p> <p><b>1.22. Young people</b> - persons up to the age of 24;</p> <p><b>1.23. Civil society organizations</b> - organizations defined according to the legislation in force;</p>	<p>obežbeđen smeštaj i staranje kroz pružanje socijalnih usluga u porodičnom okruženju biološke porodice ili van porodičnog okruženja biološke porodice;</p> <p><b>1.18. Panel za stambeno smeštanje</b> - stručni organ na centralnom i lokalnom nivou koji daje saglasnost za smeštaj deteta, punoletne i stare osobe u stambeni prostor, na osnovu procene organa starateljstva, kojima je obezbeđen smeštaj i staranje, preko pružanje socijalnih usluga;</p> <p><b>1.19. Dete</b> - lice do 18 godina;</p> <p><b>1.20. Maloletnik</b> - lice od 14 do 18 godina;</p> <p><b>1.21. Punoletnik</b> - lice koje je navršilo osamnaest (18) godina života;</p> <p><b>1.22. Mladi</b> - lica do 24 godine;</p> <p><b>1.23. Organizacije civilnog društva</b> - organizacije definisane u skladu sa zakonima na snazi;</p>
--	---	--

<p>1.24. <b>Familja</b> - nënkupton familjen sipas dispozitave të Ligjit përkatës për Familjen në Kosovë.</p> <p>1.25. <b>Prindi vetushqyes/vetmbajtës</b> - prindi i cili përkujdeset vetë për fëmijën e tij dhe e mbanë atë, përderisa prindi tjetër ka vdekur, apo është i panjohur, i zhdukur ose me vendbanim apo vendqëndrim të panjohur, i është marrë zotësia e veprimit apo e drejta prindërore, prind i shkurorëzuar ose i ndarë.</p> <p>1.26. <b>Person i vetëm</b> - personi i cili nuk është në bashkësi martesore apo jashtëmartesore, përkatësisht nuk ka familje dhe jeton i vetëm;</p> <p>1.27. <b>Bashkësia jashtëmartesore</b> - bashkësia jetësore e gruas dhe burrit të pamartuar, e cila i plotëson kushtet e parapara me ligjin e veçantë me të cilin rregullohen marrëdhëniet familjare;</p> <p>1.28. <b>Përfitues i shërbimeve sociale dhe familjare</b> - individ, anëtarët e familjes dhe familja në tërësi, të cilët realizojnë të drejta dhe shërbime në pajtim me këtë Ligj;</p> <p>1.29. <b>Person me aftësi të kufizuar</b> - personi që ka dëmtime fizike, mendore,</p>	<p>1.24. <b>Family</b> - means the family according to the provisions of the relevant Family Law in Kosovo.</p> <p>1.25. <b>Single parent</b> – a parent who takes care of his child himself and supports him, while the other parent is deceased, or is unknown, missing or of unknown residence or whereabouts, has been deprived of the capacity to act or parental rights, a divorced or separated parent.</p> <p>1.26. <b>Single person</b> - a person who is not in a marital or extramarital union, i.e. does not have a family and lives alone;</p> <p>1.27. <b>Extramarital union</b> - a life union of an unmarried woman and an unmarried man, which fulfills the conditions stipulated by the special law regulating family relations;</p> <p>1.28. <b>Beneficiary of social and family services</b> - an individual, family members and the family as a whole, who realize rights and services in accordance with this Law;</p> <p>1.29. <b>Person with a disability</b> - a person who has long-term physical,</p>	<p>1.24. <b>Porodica</b> - podrazumeva porodicu prema odredbama relevantnog Zakona o porodici na Kosovu.</p> <p>1.25. <b>Roditelj koji se samostalno izdržava</b> – roditelj koji se sam brine o svom detetu i izdržava ga, a drugi roditelj je mrtav, ili je nepoznat, nestao ili nepoznatog boravišta ili boravišta, lišen poslovne sposobnosti ili roditeljskog prava, razveden ili rastavljen roditelj.</p> <p>1.26. <b>Samac</b> – lice koje nije u bračnoj ili vanbračnoj zajednici, odnosno nema porodicu i živi samo;</p> <p>1.27. <b>Vanbračna zajednica</b> - vanbračna zajednica žene i vanbračnog muškarca, koje ispunjava uslove propisane posebnim zakonom kojim se uređuju porodični odnosi;</p> <p>1.28. <b>Korisnik socijalnih i porodičnih usluga</b> - pojedinac, članovi porodice i porodica u celini, koji ostvaruju prava i usluge u skladu sa ovim Zakonom;</p> <p>1.29. <b>Lice sa ograničenim sposobnostima</b> - osoba koja ima</p>
--	--	---

<p>intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët;</p> <p>1.30. <b>Gjendja pasurore</b> - të hyrat dhe pasuria e individit, personit të vetëm apo pasuria e familjes.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Parimet</b></p> <p>1. Shërbimet sociale udhëhiqen nga parimi i:</p> <p>1.1. respektimit të integritetit dhe dinjitetit të përfituesit të shërbimeve sociale, fëmijës apo të rriturit, i cili bazohet në drejtësinë sociale, përgjegjësinë dhe solidaritetin që ofrohet, duke respektuar integritetin fizik dhe psikik, të sigurisë, si dhe duke respektuar bindjet morale, kulturore dhe religjioze në pajtim me të drejtat dhe liritë njerëzore të garantuara;</p> <p>1.2. mosdiskriminimit të përfituesit sipas racës, gjinisë, moshës, përkatësisë kombëtare, religjionit, përkatësisë politike, sindikale apo të përcaktimit tjetër, të gjendjes pasurore, kulturës,</p>	<p>mental, intellectual or sensory impairments, which in interaction with various barriers can prevent his full and effective participation in society on an equal basis with others;</p> <p>1.30. <b>Wealth status</b> - income and wealth of the individual, single person or family wealth.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4 Principles</b></p> <p>1. Social services shall be guided by the principle of:</p> <p>1.1. respecting the integrity and dignity of the child or adult beneficiary of social services, which is based on social justice, responsibility and solidarity that is offered, respecting physical and psychological integrity, security, as well as respecting moral, cultural and religious beliefs, in accordance with guaranteed human rights and freedoms;</p> <p>1.2. non-discrimination of the beneficiary according to race, gender, age, nationality, religion, political, trade union or other affiliation, wealth status, culture, language, disability, belonging</p>	<p>dugotrajna fizička, mentalna, intelektualna ili senzorna oštećenja, koja u interakciji sa različitim preprekama mogu da spreče njegovo puno i efektivno učešće u društvu na ravnopravnoj osnovi sa drugima;</p> <p>1.30. <b>Bogatstvo</b> – prihodi i bogatstvo pojedinca, samca ili porodično bogatstvo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4 Principi</b></p> <p>1. Socijalne usluge se rukovode principom:</p> <p>1.1. poštovanje integriteta i dostojanstva korisnika socijalnih usluga, deteta ili odrasle osobe, koje se zasniva na socijalnoj pravdi, odgovornosti i solidarnosti koja se nudi, poštujući fizički i psihički integritet, bezbednost, kao i poštovanje moralnih, kulturnih i verskih uverenja, u skladu sa zagaranovanim ljudskim pravima i slobodama;</p> <p>1.2. nediskriminacija korisnika prema rasi, polu, starosti, nacionalnosti, veri, političkom opredeljenju, sindikalnom ili drugom određenju, bogatstvu, kulturi, jeziku, invalidnosti,</p>
---	---	--

<p>gjuhës, aftësisë së kufizuar, përkatësisë së grupit të caktuar shoqëror, apo cilësive tjera personale dhe të vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve sociale;</p> <p>1.3. informimit të përfituesit për të gjitha të dhënat të cilat janë të rëndësishme për përcaktimin e nevojave të tyre sociale dhe realizimit të të drejtave, si dhe për atë se si ato nevoja mund të përmbushen kënaqshëm;</p> <p>1.4. qasjes individuale dhe të lehtë tek përfituesi në ofrimin e shërbimeve sociale për të gjithë ata që janë në nevojë sociale, ashtu që këto shërbime sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit me qëllim të sigurimit të mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve;</p> <p>1.5. garantimit të pjesëmarrjes aktive të përfituesit në krijimin, zgjedhjen dhe shfrytëzimin e të drejtave sociale, i cili bazohet në pjesëmarrjen, vlerësimin e gjendjes dhe të nevojave, si dhe vendimmarrjes për pranimin e shërbimeve të nevojshme;</p>	<p>to a certain social group, or other personal qualities and continuity of providing social services;</p> <p>1.3. informing the beneficiary about all the data that are important for determining their social needs and realizing their rights, as well as how those needs can be fulfilled satisfactorily;</p> <p>1.4. individual and easy access to the beneficiary in the provision of social services to all those who are in social need, so that these services are secured and provided, as far as possible near the family or community of the beneficiary of the service in order to ensure social well-being and efficient use of funds;</p> <p>1.5. guaranteeing the active participation of the beneficiary in the creation, selection and use of social rights, which is based on participation, assessment of the condition and needs, as well as decision-making for the acceptance of the necessary services;</p>	<p>pripadnosti određenoj društvenoj grupi, ili drugim ličnim kvalitetima i neposredno pružanje socijalne usluge;</p> <p>1.3. informisanje korisnika o svim podacima koji su od značaja za utvrđivanje njihovih socijalnih potreba i ostvarivanje prava, kao i o tome kako te potrebe mogu biti zadovoljene na zadovoljavajući način;</p> <p>1.4. pojedinačni i lak pristup korisniku u pružanju socijalnih usluga svima onima koji su u socijalnoj potrebi, tako da se ove usluge pružaju , što je više moguće u blizini porodice ili zajednice korisnika usluge kako bi se obezbedilo društveni dobrobit i efikasno korišćenje sredstava;</p> <p>1.5. garantovanje aktivnog učešća korisnika u stvaranju, izboru i korišćenju socijalnih prava, koje se zasniva na učešću, proceni stanja i potreba, kao i odlučivanju za primanje potrebnih usluga;</p>
---	---	---

<p>1.6. respektimit të interesit më të mirë të përfituesit në realizimin e të drejtës në shërbime sociale;</p> <p>1.7. gjithë përfshirjes dhe pluralizmit të shërbimeve dhe i ofruesve të shërbimeve sociale sipas kushteve dhe mënyrës së paraparë me ligj;</p> <p>1.8. transparencës në pikëpamje të përfshirjes së opinionit për mbrojtjen sociale në mjetet publike të informimit, si dhe në mënyra tjera në pajtim me ligjin;</p> <p>1.9. respektimit të privatësisë me rastin e ofrimit të shërbimeve të përkujdesjes sociale të përfituesit të të drejtave në sistemin e përkujdesjes sociale.</p> <p>1.10. fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, ashtu që përfituesit e të drejtës në sistemin e kujdesit social duhet t'u sigurohet fshehtësia dhe mbrojtja e të dhënave personale në pajtim me ligjin.</p> <p>1.11. vazhdimësisë së shërbimeve sociale, që nënkupton udhëzimin dhe përcjelljen e përfituesit përgjatë një periudhe kohore përmes një pakoje gjithëpërfshirëse të shërbimeve që mbulon çdo nivel dhe intensitet të</p>	<p>1.6. respecting the best interest of the beneficiary in realizing the right to social services;</p> <p>1.7. inclusiveness and pluralism of services and providers of social services according to the conditions and manner provided by law;</p> <p>1.8. transparency in terms of the inclusion of the opinion on social protection in the public means of information, as well as in other ways in accordance with the law;</p> <p>1.9. respecting privacy when providing social care services to the beneficiary of rights in the social care system.</p> <p>1.10. secrecy and protection of personal data, so that the beneficiary of the right in the social care system must be provided with the secrecy and protection of personal data in accordance with the law.</p> <p>1.11. continuity of social services, which means the guidance and follow-up of the beneficiary over a period of time through a comprehensive package of services that covers every level and</p>	<p>1.6. uvažavajući najbolji interes korisnika u ostvarivanju prava na socijalne usluge;</p> <p>1.7. sveobuhvatnost i pluralizam usluga i pružalaca socijalnih usluga prema uslovima i na način predviđen zakonom;</p> <p>1.8. transparentnost u pogledu uključivanja mišljenja o socijalnoj zaštiti u javna sredstva informisanja, kao i na druge načine u skladu sa zakonom;</p> <p>1.9. poštovanje privatnosti prilikom pružanja usluga socijalne zaštite korisniku prava u sistemu socijalne zaštite.</p> <p>1.10. tajnosti i zaštite podataka o ličnosti, tako da se korisniku prava u sistemu socijalne zaštite mora obezbediti poverljivost i zaštita podataka o ličnosti u skladu sa zakonom.</p> <p>1.11. produžnost socijalnih usluga, što podrazumeva usmeravanje i praćenje korisnika tokom određenog vremenskog perioda kroz sveobuhvatan paket usluga koji pokriva svaki nivo i intenzitet</p>
--	---	--

<p>kujdesit shëndetësor dhe social që një personi mund t'i duhen gjatë gjithë jetës;</p> <p>1.12. mos bërjes dëm, që nënkupton se shërbimet sociale duhet të ofrohen duke u bazuar në kuptimin e kontekstit në të cilin problemet sociale të ngritura bëhen nëpërmjet një vlerësimi se si intervenimi mund të ndër veprojë kundrejt një vendimi për të ofruar shërbimet sociale duke shmangur ndikimin negativ, dhe duke arritur ndikim pozitiv;</p> <p>1.13. personit dhe familjes në qendër, nënkupton që shërbimet sociale duhen ofruar duke i'u përshtatur nevojave të secilit përfitues, duke zhvilluar plan të intervenimit individual për çdo rast në harmoni me kompleksitetin e rastit;</p> <p>1.14. ofrimin të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të integruara, që ofrohen nëpërmjet vlerësimit të cenueshmërisë së shumëfishtë të përfituesit si individ apo në grup;</p> <p>1.15. vlerësimit dhe gatishmërisë për të ofruar kualitet, që nënkupton se shërbimet sociale duhen zhvilluar me një qasje sistematike për të përmirësuar</p>	<p>intensity of health and social care that a person may need throughout life;</p> <p>1.12. doing no harm, which means that social services must be provided based on an understanding of the context in which social problems arise through an assessment of how intervention can interact with a decision to provide social services while avoiding negative impact, and achieving positive impact;</p> <p>1.13. the person and the family at the center, means that social services must be provided by adapting to the needs of each beneficiary, developing an individual intervention plan for each case in harmony with the complexity of the case;</p> <p>1.14. the provision of comprehensive and integrated services, which are offered through the assessment of the multiple vulnerability of the beneficiary as an individual or in a group;</p> <p>1.15. assessment and readiness to provide quality, which means that social services must be developed with a systematic approach to improve the</p>	<p>zdravstvene i socijalne zaštite koji bi osobi mogli biti potrebni tokom života;</p> <p>1.12. ne čineći nikakvu štetu, što znači da se socijalne usluge moraju pružati na osnovu razumevanja pojama u kome nastaju društveni problemi kroz procenu na koji način intervencija može da utiče na odluku o pružanju socijalnih usluga uz izbegavanje negativnog uticaja i postizanje pozitivnog uticaja;</p> <p>1.13. osoba i porodica u centru, znači da se socijalne usluge moraju pružati prilagođavanjem potrebama svakog korisnika, razvojem pojedinačnog plana intervencije za svaki slučaj u skladu sa složenošću slučaja;</p> <p>1.14. pružanje sveobuhvatnih i integrisanih usluga, koje se nude kroz procenu višestruke ugroženosti korisnika kao pojedinca ili u grupi;</p> <p>1.15. procenu i spremnost za obezbeđivanje kvaliteta, što znači da se socijalne usluge moraju razvijati sistemskim pristupom za unapređenje</p>
--	--	--

<p>kualitetin e shërbimeve të ofruara, si dhe metodologjinë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të programeve të reja.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI II SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5 Shërbimet sociale dhe familjare</b></p> <p>1. Shërbimet sociale dhe familjare synojnë:</p> <p>1.1. ofrimin e ndihmës ndaj individit, familjes, grupit dhe komunitetit, pavarësisht moshës, aftësisë së kufizuar, problemeve sociale, që pjesërisht apo plotësisht, përkohësisht apo përherë kanë humbur aftësinë apo mundësinë për t'u kujdesur në mënyrë të pavarur për jetën e tyre private apo të familjes si dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri;</p> <p>1.2. krijimin e kushteve për zhvillimin dhe fuqizimin e individit dhe familjes për aftësim dhe mundësi që në mënyrë të pavarur të zgjidhin problemet sociale, mbajtjen e lidhjeve me</p>	<p>quality of services provided, as well as the methodology for supervision and monitoring of the implementation of new programs.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER II SOCIAL AND FAMILY SERVICES</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5 Social and family services</b></p> <p>1. Social and family services aim at:</p> <p>1.1. providing assistance to the individual, family, group and community, regardless of age, disability, social problems, who have partially or completely, temporarily or permanently lost the ability or capability to independently take care of their private life or of the family as well as their participation in society;</p> <p>1.2. creating conditions for the development and empowerment of the individual and the family for training and opportunities to independently solve social problems, maintain ties</p>	<p>kvaliteta pruženih usluga, kao i metodologija za nadzor i praćenje realizacije novih programa.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE II SOCIJALNE I PORODIČNE USLUGE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5 Socijalne i porodične usluge</b></p> <p>1. Socijalne i porodične usluge imaju za cilj:</p> <p>1.1. pružanje pomoći pojedincu, porodici, grupi i zajednici, bez obzira na godine starosti, sa ograničenim sposobnostima, socijalne probleme, koji su delimično ili potpuno, privremeno ili trajno izgubili sposobnost ili mogućnost da samostalno brinu o svom privatnom životu ili porodici, kao i njihovo učešće u društvu;</p> <p>1.2. stvaranje uslova za razvoj i osnaživanje pojedinca i porodice za osposobljavanje i mogućnosti za samostalno rešavanje društvenih problema, održavanje veza sa društvom,</p>
--	---	---

<p>shoqërinë, si dhe për të tejkaluar përjashtimin shoqëror;</p> <p>1.3.fuqizimin e familjes dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja e tij, nëpërmjet shërbimeve që mundësojnë ndërtimin dhe ruajtjen e unitetit të familjes, e nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të mundësojë rikthimin e fëmijës në ambient familjar, duke u kujdesur për të drejtat, mirëqenien dhe në interesin më të mirë të fëmijës.</p> <p>2.Qeveria dhe komunat sigurojnë dhe ofrojnë shërbimet sociale dhe familjare në pajtim me ligjin.</p> <p>3. Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare nga paragrafi 2 i këtij neni mund t'i besohet edhe personave tjerë fizik dhe juridik të licencuar sipas ligjit.</p> <p>4. Komuna mund të përcaktoj dhe ofroj shërbime sociale dhe familjare të tjera në pajtim me nevojat e popullsisë së komunës përkatëse, si në vijim:</p> <p>4.1. ndihmë personale për personin me aftësi të kufizuar;</p> <p>4.2. mbështetje me banim;</p>	<p>with society, as well as to overcome social exclusion;</p> <p>1.3. strengthening the family and preventing the separation of the child from their family, through services that enable the construction and preservation of family unity, and if this is not possible, then it must enable the return of the child to the family environment, taking care of the rights, well-being and the best interest of the child.</p> <p>2. The government and municipalities shall secure and provide social and family services in accordance with the law.</p> <p>3. The provision of social and family services from paragraph 2 of this Article can also be entrusted to other legal and natural persons, licensed according to the law.</p> <p>4. The municipality can define and provide other social and family services in accordance with the needs of the population of the respective municipality, as follows:</p> <p>4.1. personal assistance for the disabled person;</p> <p>4.2. housing support;</p>	<p>kao i za prevazilaženje socijalne isključenosti;</p> <p>1.3. jačanje porodice i sprečavanje odvajanja deteta od porodice, kroz usluge koje omogućavaju izgradnju i očuvanje porodičnog jedinstva, a ako to nije moguće, onda mora omogućiti povratak deteta u porodičnu sredinu, staranje o njegova prava, dobrobit iu najboljem interesu deteta.</p> <p>2. Vlada i opštine pružaju socijalne i porodične usluge u skladu sa zakonom.</p> <p>3. Pružanje socijalnih i porodičnih usluga iz stava 2. ovog člana može se poveriti i drugim pravnim i fizičkim licima, licenciranim u skladu sa zakonom.</p> <p>4. Opština može definisati i pružati i druge socijalne i porodične usluge u skladu sa potrebama stanovništva relevantne opštine, i to:</p> <p>4.1.lična pomoć za osobe sa ograničenim sposobnostima;</p> <p>4.2. stambena podrška;</p>
---	--	--



<p>4.3. strehimi i mbrojtur dhe i sigurt;</p> <p>4.4.ndihmë në përkujdesjen e personave madhor pas lëshimit nga institucionet apo të familjeve strehuese;</p> <p>4.5. ndihma e njëhershme në natyrë e cila jepet në situata emergjente;</p> <p>4.6. shërbime të kuzhinës publike;</p> <p>4.7. ndihmë për shkollim të fëmijës dhe të familjes në nevojë sociale;</p> <p>4.8. ndihmë në edukim dhe arsimim të fëmijës me nevoja të veçanta arsimore;</p> <p>4.9.subvencionimi i shpenzimeve komunale për familjen e varfër;</p> <p>4.10. ndihmë në përkujdesjen banesore të familjes dhe individit të varfër si dhe atyre në nevojë;</p> <p>4.11.shpenzimet e varrimit të përfituesit të të drejtave nga ky Ligj;</p> <p>4.12.shërbimet e mbështetjes nëpërmjet linjës 24 orë të telefonit;</p>	<p>4.3. safe and secure housing;</p> <p>4.4. assistance in caring for adults after release from institutions or foster families;</p> <p>4.5. one-time help in nature which is given in emergency situations;</p> <p>4.6. public kitchen services;</p> <p>4.7. aid for the education of the child and the family in social need;</p> <p>4.8. assistance in education and training of children with special educational needs;</p> <p>4.9. subsidizing municipal expenses for the poor family;</p> <p>4.10. assistance in housing care for poor families and individuals as well as those in need;</p> <p>4.11. burial expenses of the beneficiary of the rights from this Law;</p> <p>4.12. support services via a 24-hour telephone line;</p>	<p>4.3. sigurno i bezbedno stanovanje;</p> <p>4.4. pomoć u zbrinjavanju odraslih osoba nakon puštanja iz institucija ili porodica domaćina;</p> <p>4.5. jednokratna pomoć u prirodi koja se daje u vanrednim situacijama;</p> <p>4.6. usluge javne kuhinje;</p> <p>4.7. pomoć za školovanje deteta i porodice u socijalnoj potrebi;</p> <p>4.8. pomoć u obrazovanju i obuci dece sa posebnim obrazovnim potrebama;</p> <p>4.9.subvencionisanje opštinskih troškova za siromašnu porodicu;</p> <p>4.10. pomoć u stambenom zbrinjavanju siromašnih porodica i pojedinaca kao i onih kojima je potrebna pomoć;</p> <p>4.11. troškovi sahrane korisnika prava iz ovog zakona;</p> <p>4.12. usluge podrške putem 24-časovne telefonske linije;</p>
---	---	---

<p>4.13.subvencionimi i shërbimeve të transportit lokal, dhe</p> <p>4.14. të drejta tjera dhe shërbime ndaj nevojave të qytetarëve të komunës përkatëse.</p> <p>5. Të drejtat sipas këtij Ligji realizohen pasi që të shterojnë mundësitë e disponueshme të individit apo familjes. Shërbimet sociale dhe familjare ofrohen me qëllim të parandalimit të problemeve sociale të individit, familjes, grupit dhe komunitetit, si dhe garantimit të mirëqenies dhe kohezionit social të familjes dhe të shoqërisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Përfituesit e shërbimeve sociale</b></p> <p>1. Përfituesit e shërbimeve sociale dhe familjare janë individit, anëtari i familjes dhe familja në tërësi, të cilët realizojnë të drejta dhe shërbime në pajtim me ligjin.</p> <p>2. Të drejtat e përfituesve të shërbimeve sociale realizohen përmes mbështetjes financiare, me shërbime sociale dhe me masa tjera të cilat i ofrohen individit, anëtarit të familjes apo familjes.</p>	<p>4.13 subsidizing local transport services, and</p> <p>4.14. other rights and services to the needs of the citizens of the respective municipality.</p> <p>5. The rights according to this law are realized after exhausting the available possibilities of the individual or the family. Social and family services are provided with the aim of preventing social problems of the individual, family, group and community, as well as guaranteeing the well-being and social cohesion of the family and society.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Beneficiaries of social services</b></p> <p>1. The beneficiaries of social and family services are the individual, the family member and the family as a whole, who realize rights and services in accordance with the law.</p> <p>2.The rights of beneficiaries of social services are realized through financial support, social services and other measures offered to the individual, family member or family.</p>	<p>4.13 subvencionisanje usluga lokalnog prevoza, i</p> <p>4.14. druga prava i usluge za potrebe građana relevantne opštine.</p> <p>5. Prava po ovom zakonu ostvaruju se nakon iscrpljivanja raspoloživih mogućnosti pojedinca ili porodice. Socijalne i porodične usluge pružaju se sa ciljem prevencije socijalnih problema pojedinca, porodice, grupe i zajednice, kao i garantovanja dobrobit i socijalne kohezije porodice i društva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Korisnici socijalnih usluga</b></p> <p>1. Korisnici socijalnih i porodičnih usluga su pojedinac, član porodice i porodica u celini, koji prava i usluge ostvaruju u skladu sa zakonom.</p> <p>2.Prava korisnika socijalnih usluga ostvaruju se kroz finansijsku podršku, socijalne usluge i druge mere koje se nude pojedincu, članu porodice ili porodici.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Trajtimi i barabartë</b></p> <p>1. Përfituesi i shërbimeve sociale ka të drejtë në mbrojtje sociale, e cila bazohet në trajtim të barabartë dhe të drejtë.</p> <p>2. Ndalohet çdo formë e diskriminimit në realizimin e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve sociale dhe familjare.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Equal treatment</b></p> <p>1. The beneficiary of social services has the right to social protection, which is based on equal and fair treatment.</p> <p>2. Any form of discrimination in the implementation of social protection and social and family services is prohibited.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Jednako postupanje</b></p> <p>1. Korisnik socijalne usluge ima pravo na socijalnu zaštitu, koja se zasniva na jednakom i pravičnom postupanju.</p> <p>2. Zabranjen je svaki diskriminacije u sprovođenju socijalne zaštite i socijalnih i porodičnih usluga.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare</b></p> <p>1. Ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare janë Qeveria dhe Komunat.</p> <p>2. Shërbimet sociale dhe familjare, përveç institucioneve publike të shërbimeve sociale mund t'i ofrojnë edhe organizatat joqeveritare, personat fizik e juridik në pajtim me ligjin.</p> <p>3. Qeveria përcakton sistemin e shërbimeve sociale, harton politika dhe strategji zhvillimore, të drejtat dhe kriteret për përfituesit e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe siguron realizimin e të drejtave të parapara me ligj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Social and family service providers</b></p> <p>1. Providers of social and family services are the Government and the Municipalities.</p> <p>2. Social and family services, in addition to public institutions of social services, can also be offered by non-governmental organizations, natural and legal persons in accordance with the law.</p> <p>3. The government defines the system of social services, designs development policies and strategies, rights and criteria for the beneficiaries of social and family services, as well as ensures the realization of the rights provided by law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Pružaoци socijalnih i porodičnih usluga</b></p> <p>1. Pružaoци socijalnih i porodičnih usluga su Vlada i Opštine.</p> <p>2. Socijalne i porodične usluge, pored javnih institucija socijalnih usluga, mogu pružati i nevladine organizacije, fizička i pravna lica u skladu sa zakonom.</p> <p>3. Vlada utvrđuje sistem socijalnih usluga, izrađuje razvojne politike i strategije, prava i kriterijume za korisnike socijalnih i porodičnih usluga, kao i obezbeđuje ostvarivanje zakonom predviđenih prava.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Strehimi rezidencial</b></p> <p>1.Strehimi rezidencial është formë e mbrojtjes së fëmijës pa kujdes prindëror, të rriturit dhe të moshuarit pa kujdes familjar, i cila sigurohet nëpërmjet banimit dhe plotësimit të nevojave themelore jetësore, si dhe mbrojtjes shëndetësore të përfituesit i cili nuk ka kushte për të qëndruar në familje</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Residential care (housing)</b></p> <p>1. Residential care (housing) is a form of protection for children without parental care, adults and the elderly without family care, which is provided through housing and the fulfillment of basic life needs, as well as health protection of the beneficiary who does not have the conditions to stay in the family</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Stambeni smeštaj</b></p> <p>1. Stambeni smeštaj je oblik zaštite dece bez roditeljskog staranja, odraslih i starih osoba bez porodičnog staranja, koji se obezbeđuje kroz stanovanje i zadovoljenje osnovnih životnih potreba, kao i zdravstvenu zaštitu korisnika koji nema uslove za boravak u porodici i kojima se ne mogu obezbediti</p>

<p>dhe të cilit nuk mund t'i sigurohet shërbimi social nëpërmjet strehimit familjar dhe shërbimit në familje.</p> <p>2.Përrjashtimisht, kur format e tjera të strehimit dhe të kujdesit nuk mund të sigurohen dhe situata e nevojës për mbrojtje për fëmijën është emergjente, fëmija vendoset përkohësisht në strehim rezidencial për fëmijë.</p> <p>3.Ambientet që ofrojnë strehim rezidencial duhet të jenë të vogla dhe të organizuara mirë për mbrojtjen e të drejtave dhe plotësimin e nevojave të fëmijës në ambiente që i ngjasojnë sa më shumë mjediseve familjare.</p> <p>4. Përveç nevojave nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, sigurohet edhe qasja në arsim dhe aspekte tjera që ndikojnë në zhvillimin e kapaciteteve psiko - fizike të fëmijës.</p> <p>5. Shërbimet e strehimit rezidencial i ofrohen përfituesit që t'i sigurojnë përgatitjen për kthimin e tij në familjen biologjike, strehimin në familje tjetër, përkatësisht, përgatitjen e tij për jetë të pavarur në pajtim me burimet familjare, nevojat dhe interesin më të mirë të tij.</p> <p>6. Me rastin e zgjedhjes për të drejtën e përfituesit në strehim rezidencial, organet</p>	<p>and who cannot be provided with social services through family housing and family service.</p> <p>2.Exceptionally, when other forms of housing and care cannot be provided and the situation of the child's need for protection is urgent, the child is temporarily placed in residential housing for children.</p> <p>3. The facilities that offer residential housing should be small and well organized to protect the rights and meet the needs of the child in facilities that resemble family environments as much as possible.</p> <p>4. In addition to the needs from paragraph 1 and 2 of this Article, access to education and other aspects that affect the development of the child's psycho-physical capacities are also ensured.</p> <p>5. Residential housing services are provided to the beneficiary to ensure preparation for his return to the biological family, housing in another family, respectively, his preparation for independent life, in accordance with family resources, needs and his/her best interest.</p> <p>6. In the case of choosing for the beneficiary's right to residential housing, the competent</p>	<p>socijalne usluge putem porodičnog stanovanja i porodične usluge.</p> <p>2. Izuzetno, kada se ne mogu obezbediti drugi oblici smeštaja i zbrinjavanja, a postoji hitna potreba deteta za zaštitom, dete se privremeno smešta u stambeni smeštaj za decu.</p> <p>3. Objekti koji obezbeđuju stambeni smeštaj treba da budu mali i dobro organizovani da štite prava i zadovoljavaju potrebe deteta u objektima koji što više liče na porodično okruženje.</p> <p>4. Pored potreba iz stava 1. i 2. ovog člana, obezbeđuje se i pristup obrazovanju i drugi aspekti koji utiču na razvoj psihofizičkih sposobnosti deteta.</p> <p>5. Usluge stambenog smeštaja pružaju se korisniku radi pripreme za njegov povratak u biološku porodicu, stanovanje u drugoj porodici, odnosno njegovu pripremu za samostalan život, u skladu sa porodičnim resursima, potrebama i njegovim najboljim interesom.</p> <p>6. Prilikom izbora prava korisnika na stambeni smeštaj, nadležni organi ispituju</p>
--	--	---

<p>kompetente shqyrtojnë të gjitha mundësitë e tjera dhe llojet e shërbimeve jashtë strehimit rezidencial, dhe strehimin rezidencial e aplikojnë kur nuk ekziston mundësi tjera, veçmas me kujdes të shuar për fëmijët nën moshën 3 vjeçare.</p> <p>7. Shërbime të strehimit rezidencial mund të ofrojnë ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare, i cili e ka marrë licencën dhe pëlqimin për ofrimin e këtyre shërbimeve.</p> <p>8. Kushtet për ofrimin e strehimit rezidencial, llojet e strehimit, kushtet për kryerjen e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur, rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.</p>	<p>bodies examine all other options and types of services outside of residential housing, and apply residential housing when there are no other options, especially with increased care for children under the age of 3 years.</p> <p>7. Residential housing services can be provided by the provider of social and family services, who has obtained the license and consent for the provision of these services.</p> <p>8. The conditions for the provision of residential housing, the types of housing, the conditions for providing housing, the types and number of established beneficiaries, are regulated by a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>sve druge mogućnosti i vrste usluga van stambenog smeštaja, a stambeni smeštaj primenjuju kada nema drugih mogućnosti, osim uz posebnu negu o deci mlađoj od 3 godine.</p> <p>7. Usluge stambenog smeštaja može pružati pružalac socijalnih i porodičnih usluga, koji je dobio dozvolu i saglasnost za pružanje ovih usluga.</p> <p>8. Uslovi za stambeni smeštaj , vrste smeštaja, uslovi smeštaja, vrste i broj osnovanih korisnika, uređuju se podzakonskim aktom koji donosi Ministar.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Strehimi në situata emergjente</b></p> <p>1. Me strehim në qendrën emergjente të pranimit, përfituesit i sigurohet strehimi dhe siguria për një periudhë të shkurtër kohore, deri në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për situatat e krizës, plotësimin e nevojave themelore të tij dhe qasje në shërbime tjera.</p> <p>2. Shërbimin e strehimit në qendrën e pranimit e siguron Ministria dhe komuna, ndërsa shërbimin e ofrojnë institucionet e shërbimeve sociale, organizatat joqeveritare</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Housing (shelter) in emergency situations</b></p> <p>1. With accommodation in the emergency reception center, the beneficiary is provided with shelter and security for a short period of time, until finding sustainable solutions to crisis situations, meeting his basic needs and accessing other services.</p> <p>2. The shelter service at the reception center is secured by the Ministry and the municipality, while the service is provided by social service institutions, non-governmental</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Smeštaj u vanrednim situacijama</b></p> <p>1. Uz smeštaj u hitnom prihvatnom centru, korisniku se obezbeđuje zaklon i bezbednost na kratak vremenski period, do iznalaženja održivih rešenja za krizne situacije, zadovoljavanja osnovnih potreba i pristupa drugim uslugama.</p> <p>2. Uslugu smeštaja u hitnom prihvatnom centru obezbjeđuju Ministarstvo i opština, a usluge institucije socijalne zaštite, nevladine</p>

<p>edhe personat e tjerë fizik e juridikë të licencuar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Shërbimet e intervenimeve emergjente</b></p> <p>1. Shërbimet sociale mund të ofrohen në formën e intervenimeve emergjente me qëllim të garantimit të sigurisë në situatat të cilat e rrezikojnë jetën, shëndetin dhe zhvillimin e përfituesit dhe sigurohen 24 orë në ditë.</p> <p>2. Shërbimet e intervenimeve emergjente i siguron Ministria dhe komuna ndërsa i ofron Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me organet dhe akterët e tjerë kompetent.</p>	<p>organizations and other licensed natural and legal persons..</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Emergency intervention services</b></p> <p>1. Social services can be provided in the form of emergency interventions in order to guarantee safety in situations that endanger the life, health and development of the beneficiary and are provided 24 hours a day.</p> <p>2. Emergency intervention services are secured by the Ministry and municipalities, while they are provided by the Center for Social Work in cooperation with other competent bodies and actors.</p>	<p>organizacije i druga licencirana fizička i pravna lica.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Usluge hitnih intervencija</b></p> <p>1. Socijalne usluge se mogu pružati u obliku hitnih intervencija u cilju garantovanja bezbednosti u situacijama koje ugrožavaju život, zdravlje i razvoj korisnika i pružaju se 24 časa dnevno.</p> <p>2. Usluge hitne intervencije pružaju Ministarstvo i opštine, a Centar za socijalni rad ih pruža u saradnji sa drugim nadležnim organima i akterima.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Adoptimi dhe procedura</b></p> <p>1. Adoptimi është formë themelore e përhershme e mbrojtjes juridike dhe familjare, që i ofrohet fëmijës pa kujdes prindëror, që nënkupton bartjen e përhershme të të drejtave dhe përgjegjësive prindërore tek prindi/prindërit adoptues;</p> <p>2. Adoptimi, është i lejuar nëse i shërben interesit më të mirë të fëmijës dhe nëse pritet që mes prindit apo prindërve adoptues dhe fëmijës do të krijohet marrëdhënia prind-</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Adoption and procedure</b></p> <p>1. Adoption is a basic permanent form of legal and family protection, offered to a child without parental care, which means the permanent transfer of parental rights and responsibilities to the adoptive parent/parents;</p> <p>2. Adoption is allowed if it serves the best interest of the child and if it is expected that a parent-child relationship will be created between the adoptive parent or parents and</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Usvojenje i postupak</b></p> <p>1. Usvojenje je osnovni trajni oblik pravne i porodične zaštite, koji se nudi detetu bez roditeljskog staranja, što podrazumeva trajni prenos roditeljskih prava i obaveza na usvojioca/roditelja;</p> <p>2. Usvojenje je dozvoljeno ako služi najboljem interesu deteta i ako se očekuje da će se između usvojitelja ili roditelja i deteta uspostaviti odnos roditelj-dete, što</p>



<p>fëmijë që nënkupton themelimin e njëjtë të të drejtave dhe detyrimeve që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijës;</p> <p>3.Shërbimet sociale dhe familjare në procesin e adoptimit ofrohen nga organi i kujdestarisë për vlerësimin profesional të nevojave të fëmijës së mundshëm për adoptim dhe vlerësimin profesional të personave të mundshëm adoptues, si dhe të përshtatshmërisë së tyre për adoptim të fëmijës, para marrjes së vendimit nga gjykata.</p> <p>4. Organi i Kujdestarisë përgatitë dhe ofron mendim profesional gjatë marrjes së vendimit nga gjykata mbi adoptimin.</p> <p>5.Paneli për Adoptim ofron mendim profesional për adoptim vendor dhe pëlqim për adoptim ndërkombëtar të fëmijës, i cili pëlqim i dërgohet gjykatës para marrjes së vendimit nga gjykata.</p> <p>6. Paneli për Adoptim mban regjistrin e fëmijëve dhe familjeve të cilët janë të vlerësuar nga Organi i Kujdestarisë dhe të cilët i plotësojnë kushtet për adoptim.</p> <p>7.Procedurat për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e adoptimit rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.</p>	<p>the child, which means the establishment of the same rights and obligations that exist between the parents and the child;</p> <p>3. Social and family services in the adoption process are provided by the guardianship body for the professional assessment of the needs of the potential child for adoption and the professional assessment of potential adoptive persons, as well as their suitability for adopting the child, before the decision is taken by the court.</p> <p>4. The Guardianship Body prepares and offers professional opinion during the adoption decision by the court.</p> <p>5. The Adoption Panel offers a professional opinion on local adoption and consent for international adoption of the child, which consent is sent to the court before the decision is taken by the court.</p> <p>6. The Adoption Panel keeps the register of children and families who are evaluated by the guardianship body and who meet the conditions for adoption.</p> <p>7. The procedures for the provision of social and family services in the adoption process are regulated by a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>podrazumeva uspostavljanje istih prava i obaveza koje postoje između roditelja i deteta ;</p> <p>3. Socijalne i porodične usluge u postupku usvojenja pruža organ starateljstva za stručnu procenu potreba potencijalnog deteta za usvojenjem i stručnu procenu potencijalnih usvojitelja, kao i njihove podobnosti za usvojenje deteta, pre donošenja odluke koju donosi sud.</p> <p>4. Organ starateljstva priprema i daje stručno mišljenje prilikom donošenja odluke suda.</p> <p>5. Panel za usvojenje daje stručno mišljenje o lokalnom usvojenju i saglasnosti za međunarodno usvojenje deteta, a saglasnost se dostavlja sudu pre donošenja sudske odluke.</p> <p>6. Panel za usvojenje vodi registar dece i porodica koje ocenjuje organ starateljstva i koji ispunjavaju uslove za usvojenje.</p> <p>7. Postupak za pružanje socijalnih i porodičnih usluga u procesu usvajanja uređuju se podzakonskim aktom koji donosi Ministar.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Jetesa e pavarur e mbikëqyrur dhe aftësimi për jetë dhe punë të pavarur</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Supervised independent living and training for independent living and work</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Nadzorni samostalan život i osposobljavanje za samostalan život i rad</b></p>
<p>1. Jetesa e pavarur e mbikëqyrur është një formë e mbrojtjes dhe e kujdesit alternativ si vazhdim i mbështetjes për fëmijën që ka qenë pjesë e çdo forme të kujdesit alternativ për të forcuar aftësitë e tij për jetesë të pavarur në një mjedis të sigurt dhe mbështetës.</p> <p>2. Jetesa e pavarur e mbikëqyrur si shërbim ofrohet gjatë qëndrimit në strehim familjar dhe strehim rezidencial nga organizata joqeveritare, personat fizik e juridik me kapacitete profesionale për ofrimin e shërbimeve.</p> <p>3. Jetesa e pavarur e mbikëqyrur është një shërbim 24 orë çdo ditë gjatë javës që mund të ofrohet të afat të shkurtër ose të gjatë.</p> <p>4. E drejta për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur i takon edhe personit me aftësi të kufizuar me pajtim me ligjin.</p> <p>5. Fëmija deri në moshën 18 vjeç e gëzon këtë të drejtë në radhë të parë.</p> <p>6. I rrituri i cili nuk është në gjendje të punojë për shkak të aftësisë së kufizuar dhe i cili nuk</p>	<p>1. Supervised independent living is a form of protection and alternative care as a continuation of support for the child who has been part of any form of alternative care to strengthen his skills for independent living in a safe and supportive environment.</p> <p>2. Supervised independent living as a service is offered during the stay in foster care and residential care by non-governmental organizations, natural and legal persons with professional capacities for providing services.</p> <p>3. Supervised independent living is a 24 hour service every day of the week that can be provided short or long term.</p> <p>4. The right to training for living and independent work also belongs to the disabled person in accordance with the law.</p> <p>5. The child up to the age of 18 enjoys this right in the first instance.</p> <p>6. The adult who is unable to work due to disability and who does not have sufficient</p>	<p>1. Samostalni život pod nadzorom je oblik zaštite i alternativne nege kao nastavak podrške detetu koje je bilo deo bilo kog oblika alternativnog zbrinjavanja u jačanju njegovih veština za samostalan život u bezbednom i podržavajućem okruženju.</p> <p>2. Samostalni život pod nadzorom kao uslugu tokom boravka u porodičnom i stambenom smeštaju pružaju nevladine organizacije, fizička i pravna lica sa stručnim kapacitetima za pružanje usluga.</p> <p>3. Samostalni život pod nadzorom je 24-časovna usluga svakog dana u nedelji koja se može pružiti kratkoročno ili dugoročno.</p> <p>4. Pravo na osposobljavanje za život i samostalan rad ima i lice sa ograničenim sposobnostima u skladu sa zakonom.</p> <p>5. Ovo pravo u prvom stepenu uživa dete do 18 godina.</p> <p>6. Punoletnoj osobi koje je zbog ograničenje sposobnosti nesposobno za rad i koje nema</p>

<p>ka mjete të mjaftueshme financiare për shpenzimet e tij jetësore, do t'i sigurohet mbështetje institucionale dhe sociale derisa të përfundojë një situatë e tillë.</p> <p>7. E drejta për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur mund të ushtrohet nga personat e moshuar, nëse për shkak të arsyeve të caktuara nuk kanë mundur të përfundojnë aftësimin për jetesë të pavarur.</p> <p>8. Të rinjtë mund të ushtrojnë të drejtën e aftësimin për jetesë dhe punë të pavarur vetëm pas vlerësimit të komisionit profesional. të tjera të kujdesit alternativ dhe për të cilin nuk është gjetur zgjidhje pas kujdesit afatgjatë, pasi të ketë arritur moshën madhore, do të vazhdojë të marrë mbështetje institucionale dhe sociale për të paktën tre vitet e ardhshme.</p> <p>9. Pas periudhës trevjeçare, mbështetja mund të vazhdohet për një periudhë të caktuar, për raste specifike pas një rivlerësimi të nevojave të individit nga organi kompetent, por jo më shumë se 26 vjeç. Kjo mbështetje do të vazhdojë të ofrohet deri në moshën 26 vjeç, nëse ai është duke ndjekur edukimin e tij.</p> <p>10. E drejta për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur, i'u sigurohet përfituesve përmes ofruesit përkatës të shërbimeve.</p>	<p>financial means for his living expenses, will be provided with institutional and social support until such situation ends.</p> <p>7. The right to training for independent living and work can be exercised by elderly people, if due to certain reasons they could not complete the training for independent living.</p> <p>8. Young people can exercise the right of training for independent living and work only after the evaluation of the professional commission, other of alternative care and for which no solution has been found after long-term care, after reaching adulthood, will continue to receive institutional and social support for at least the next three years.</p> <p>9. After the three-year period, the support can be continued for a certain period, for specific cases after a reassessment of the individual's needs by the competent body, but not more than 26 years. This support will continue to be provided until the age of 26, if he is pursuing his education.</p> <p>10. The right to training for independent living and work is provided to the</p>	<p>dovoljna finansijska sredstva za troškove života, pružaće se institucionalna i socijalna podrška do prestanka takvog stanja.</p> <p>7. Pravo na osposobljavanje za samostalan život i rad mogu ostvariti i starija lica, ako iz određenih razloga nisu mogla da završe obuku za samostalan život.</p> <p>8. Mladi mogu da ostvare pravo na samostalan život i rad tek nakon procene stručne komisije drugo alternativna nega i za koje nije pronađeno rešenje nakon dugotrajne nege, nakon punoletstva, nastaviće da prima institucionalnu i socijalnu podršku najmanje naredne tri godine,</p> <p>9. Po isteku trogodišnjeg perioda, podrška se može nastaviti na određeni period, za određene slučajeve nakon ponovne procene potreba pojedinca od strane nadležnog organa, ali ne duže od 26 godina. Ova podrška će se i dalje pružati do 26. godine, ako se školovao.</p> <p>10. Pravo na osposobljavanje za život i samostalan rad korisnicima se obezbeđuje preko odgovarajućeg pružaoca usluga.</p>
--	---	---

<p>11. Procedura për përcaktimin e fakteve dhe ekzistencën e bazës për realizimin e të drejtave për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur, kryhet nga komisioni përkatës profesional.</p> <p>12. Personi i aftësuar për jetesë dhe punë të pavarur ka të drejtë për kompensim monetar gjatë kohës së punësimit.</p> <p>13. Organi kompetent përcakton kategoritë përkatëse për fëmijën dhe të riun që do të përfitojnë nga kjo formë e mbështetjes.</p> <p>14. Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e mbështetjes së jetesës së pavarur dhe të mbikëqyrur dhe aftësimin për jetën dhe punën e pavarur, rregullohet me akt nënligjor të nxjerr Ministri.</p>	<p>beneficiaries through the relevant service provider.</p> <p>11. The procedure for determining the facts and the existence of the basis for the realization of the rights for training for living and independent work, is carried out by the relevant professional commission.</p> <p>12. The person trained for independent living and working has the right to monetary compensation during the time of employment.</p> <p>13. The competent body determines the relevant categories for the child and youth who will benefit from this form of support.</p> <p>14. The provision of social and family services in the process of supporting independent and supervised living and training for independent life and work is regulated by a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>11. Postupak za utvrđivanje činjeničnog stanja i postojanja osnova za ostvarivanje prava na osposobljavanje za život i samostalan rad, sprovodi nadležna stručna komisija.</p> <p>12. Lice sposobno za samostalan život i rad ima pravo na novčanu naknadu za vreme zaposlenja.</p> <p>13. Nadležni organ utvrđuje relevantne kategorije za dete i omladinu koji će koristiti ovaj oblik podrške.</p> <p>14. Pružanje socijalnih i porodičnih usluga u postupku podrške samostalnom i nadzornom životu i osposobljavanju za samostalan život i rad uređuje se podzakonskim aktom koji donosi Ministar.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI IV PËRFITUESIT E SHËRBIMEVE SOCIALE</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>CHAPTER IV BENEFICIARIES OF SOCIAL SERVICES</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE IV KORISNICI SOCIJALNIH USLUGA</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 29 Përfituesit e të drejtave nga shërbimet sociale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29 Beneficiaries of rights to social services</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29 Korisnici prava iz socijalnih usluga</b></p>
<p>1. Përfituesit e shërbimeve sociale janë shtetasit e Republikës së Kosovës me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Kosovës, apo personi tjetër i cili për çfarëdo arsye gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, i cili gjendet në gjendje të nevojës, gëzon të drejtën, duke mos u kufizuar vetëm në rastet si në vijim:</p> <p>1.1. Fëmija:</p> <p>1.1.1. pa përkujdesje prindërore;</p> <p>1.1.2. i lënë pas dore;</p> <p>1.1.3. i keqtrajtuar;</p> <p>1.1.4. në konflikt apo kontakt me ligjin;</p> <p>1.1.5. zhvillimi i të cilit është penguar nga rrethanat familjare;</p>	<p>1. Beneficiaries of social services are citizens of the Republic of Kosovo with residence or temporary residence in the territory of the Republic of Kosovo, or any other person who for any reason is in the territory of the Republic of Kosovo, who is in a state of need, enjoys the right, without being limited only to the following cases:</p> <p>1.1. A child:</p> <p>1.1.1. without parental care;</p> <p>1.1.2. neglected;</p> <p>1.1.3. mistreated;</p> <p>1.1.4. in conflict or contact with the law;</p> <p>1.1.5. whose development is hindered by family circumstances;</p>	<p>1. Korisnici socijalnih usluga su državljani Republike Kosovo sa prebivalištem ili mestom prebivališta na teritoriji Republike Kosovo, ili bilo koja druga osoba koje se iz bilo kog razloga nalazi na teritoriji Republike Kosovo, a koje je u državi potreba, uživa pravo, ne ograničavajući se na sledeće slučajeve:</p> <p>1.1. Dete:</p> <p>1.1.1. bez roditeljskog staranja;</p> <p>1.1.2. zanemaren;</p> <p>1.1.3. zlostavljeni;</p> <p>1.1.4. u sukobu ili kontaktu sa zakonom;</p> <p>1.1.5. čiji razvoj ometaju porodične prilike;</p>

<p>1.1.6. me aftësi të kufizuar fizike, mendore dhe intelektuale apo shqisore afatgjata;</p> <p>1.1.7. viktimë e dhunës në familje, me bazë gjinore dhe formave tjera të dhunës;</p> <p>1.1.8. viktimë e trafikimit me njerëz;</p> <p>1.1.9. viktimë e keqpërdorimit të substancave narkotike, psiko-aktive dhe të formave tjera të varësisë;</p> <p>1.1.10. i përfshirë në punë të rënda;</p> <p>1.1.11. i pa shoqëruar, si përgjatë migrimit, zhvendosjes si pasojë e luftërave apo tërmeteve;</p> <p>1.1.12. apo, të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e kujdesit social;</p> <p>1.2. Personi madhor:</p> <p>1.2.1. me aftësi të kufizuar fizike, mendore dhe intelektuale apo shqisore afatgjata;</p> <p>1.2.2. materialisht i pasiguruar dhe në gjendje të varfërisë;</p>	<p>1.1.6. with long-term physical, mental and intellectual or sensory disabilities;</p> <p>1.1.7. victim of domestic, gender-based violence and other forms of violence;</p> <p>1.1.8. victim of human trafficking;</p> <p>1.1.9. victim of misuse of narcotic, psycho-active substances and other forms of addiction;</p> <p>1.1.10. engaged in hard labour;</p> <p>1.1.11. unaccompanied, as during migration, displacement as a result of wars or earthquakes;</p> <p>1.1.12. or who, due to special circumstances, needs an appropriate form of social care;</p> <p>1.2. An adult:</p> <p>1.2.1. with long-term physical, mental and intellectual or sensory disabilities;</p> <p>1.2.2. materially insecure and in a state of poverty;</p>	<p>1.1.6. sa dugotrajnim fizičkim, mentalnim i intelektualnim ili čulne ograničenjem sposobnosti;</p> <p>1.1.7. žrtva nasilja u porodici, rodno zasnovanog i drugih oblika nasilja;</p> <p>1.1.8. žrtva trgovine ljudima;</p> <p>1.1.9. žrtva zloupotrebe opojnih droga, psihoaktivnih supstanci i drugih oblika zavisnosti;</p> <p>1.1.10. uključeni u težak rad;</p> <p>1.1.11. bez pratnje, kao tokom migracije, raseljavanja kao posledica ratova ili zemljotresa;</p> <p>1.1.12. ili kome je zbog posebnih okolnosti potreban odgovarajući oblik socijalne zaštite;</p> <p>1.2. Odrasla osoba:</p> <p>1.2.1. dugotrajnim fizičkim, mentalnim i intelektualnim ili čulne ograničenjem sposobnosti;</p> <p>1.2.2. materijalno nesigurno i u stanju siromaštva;</p>
---	---	---

<p>1.2.3. i rrituri dhe i moshuari pa përkujdesje familjare;</p> <p>1.2.4. me sjellje negative shoqërore;</p> <p>1.2.5. viktimë e dhunës në familje, me bazë gjinore dhe të formave tjera të dhunës dhe abuzimit;</p> <p>1.2.6. viktimë e trafikimit me qenie njerëzore;</p> <p>1.2.7. përdorues i substancave narkotike, psiko-aktive dhe të formave tjera të varësisë;</p> <p>1.2.8. i pastrehë;</p> <p>1.2.9. të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet forma përkatëse e shërbimit social;</p> <p>1.2.10. prind i ri në nevojë me fëmijë nën 3 vjeç, e sipas nevojës edhe pas kësaj moshe.</p> <p>2. Shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni në pajtim me ligjin.</p>	<p>1.2.3. an adult and an elderly without family care;</p> <p>1.2.4. with negative social behavior;</p> <p>1.2.5. victim of domestic, gender-based violence and other forms of violence and abuse;</p> <p>1.2.6. victim of human trafficking;</p> <p>1.2.7. user of narcotic, psychoactive substances and other forms of addiction;</p> <p>1.2.8. homeless;</p> <p>1.2.9. who, due to special circumstances, needs the appropriate form of social service;</p> <p>1.2.10. a young parent in need with children under 3 years old, and if necessary even after this age.</p> <p>2. Foreign citizens or stateless persons may exercise the rights defined in paragraph 1 of this Article in accordance with the law.</p>	<p>1.2.3. odrasli i stari bez porodičnog staranja;</p> <p>1.2.4. sa negativnim društvenim ponašanjem;</p> <p>1.2.5. žrtva nasilja u porodici, rodno zasnovanog i drugih oblika nasilja i zlostavljanja;</p> <p>1.2.6. žrtva trgovine ljudima;</p> <p>1.2.7. korisnik narkotika, psihoaktivnih supstanci i drugih oblika zavisnosti;</p> <p>1.2.8. beskućnici;</p> <p>1.2.9. kome je zbog posebnih okolnosti potreban odgovarajući oblik socijalne usluge;</p> <p>1.2.10. mladi roditelj u potrebi sa decom do 3 godine, a po potrebi i posle ovog uzrasta.</p> <p>2. Strani državljani ili lica bez državljanstva mogu ostvariti prava iz stava 1. ovog člana u skladu sa zakonom.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Fëmija përfitues i shërbimeve sociale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Child beneficiary of social services</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Detë korisnik socijalnih usluga</b></p>
<p>1.Fëmija përfitues i shërbimit social, përfshinë fëmijën:</p> <p>1.1 pa përkujdesje prindërore, i cili është pa të dy prindërit, është i prindërve të panjohur, i braktisur nga prindërit, i prindërve të cilëve iu është marrë e drejta që të jetojnë me fëmijën, i prindërve të cilët janë privuar nga e drejta prindërore dhe fëmija i prindërve të penguar që të kryejnë detyrën prindërore si të burgosur, hospitalizuar, në arrati, me punë të përkohshme jashtë vendit, fëmija i prindërve të zhdukur, fëmija i prindërve me sëmundje apo ç'rregullime të rënda mendore, si dhe fëmija pa shtëpi;</p> <p>1.2. i lënë pas dore, i cili për shkak të mbikëqyrjes dhe përkujdesit të pamjaftueshëm të prindërve apo kujdestarëve, dhe të ndikimit negativ të mjedisit ka nevojë për mbrojtje;</p> <p>1.3. që ka braktisur shkollimin dhe edukimin e rregullt, i cili është në konflikt me ligjin dhe i cili me sjelljen e tij shkel normat e përgjithshme të</p>	<p>1. Child beneficiary of the social service includes the child:</p> <p>1.1 without parental care, who is without both parents, is of unknown parents, abandoned by parents, of parents who have been deprived of the right to live with the child, of parents who have been deprived of parental rights and the child of parents prevented from performing their parental duties such as (imprisoned, hospitalized, on the run, with temporary work abroad, the child of missing parents, the child of parents with serious mental illnesses or disorders, as well as the child without a home ;</p> <p>1.2. a neglected child, who due to insufficient supervision and care of parents or guardians, and the negative influence of the environment, needs protection;</p> <p>1.3. who has abandoned schooling and regular education, who is in conflict with the law and who with his behavior violates the generally accepted norms,</p>	<p>1. Detë korisnik socijalne usluge obuhvata detë:</p> <p>1.1 bez roditeljskog staranja, koji je bez oba roditelja, nepoznatih roditelja, napuštenih od roditelja, roditelja kojima je oduzeto pravo da žive sa detetom, roditelja koji su lišeni roditeljskog prava i deteta roditelja sprečenog da obavljanje roditeljskih obaveza kao što su (zatvoreno, hospitalizovano, u bekstvu, na privremenom radu u inostranstvu, dete nestalih roditelja, dete roditelja sa teškim psihičkim oboljenjima ili smetnjama, kao i dete bez doma;</p> <p>1.2. zanemareni, kojima je zbog nedovoljnog nadzora i brige roditelja ili staratelja, te negativnog uticaja okoline potrebna zaštita;</p> <p>1.3. koji je odustao od školovanja i redovnog školovanja, koji je u suprotnosti sa zakonom i koji svojim ponašanjem krši opšte prihvaćene</p>



<p>pranuara, duke përfshirë edhe fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale;</p> <p>1.4. zhvillimi i të cilit është penguar nga rrethanat familjare, prindërit e të cilit nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë kushte normale për zhvillim fizik, psikik dhe emocional, si dhe edukim të drejtë;</p> <p>1.5. me aftësi të kufizuar;</p> <p>1.6. viktimë e dhunës në familje, me bazë gjinore dhe formave tjera të dhunës, viktimë e dhunës fizike, psikike ose seksuale dhe të cilit i është shkaktuar dëmtim fizik, mendor, apo cenimi i të drejtave dhe lirive të tij, sipas parimit të barazisë në sferën publike apo private të jetës;</p> <p>1.7. viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, i cili është rrëmbyer, fshehur, transportuar apo i pranuar me dhunë me qëllim të eksploatimit, edhe nëse nuk është përdorur ndonjë nga mjetet e kërcënimit apo të përdorimit të forcës, detyrimit, mashtrimit, gënjimit apo formës së ngjashme pa marrë parasysh nëse fëmija e ka dhënë apo jo vullnetarisht apo nëpërmjet mashtrimit dhe lajthitjes pëlqimin e tij.</p>	<p>including the child under the age of criminal responsibility;</p> <p>1.4. whose development has been hindered by family circumstances, whose parents are unable to provide him with normal conditions for physical, mental and emotional development, as well as proper education;</p> <p>1.5. with disabilities;</p> <p>1.6. a victim of domestic, gender-based violence and other forms of violence, a victim of physical, mental or sexual violence and who has suffered physical, mental damage, or violation of his rights and freedoms, according to the principle of equality in the public or private sphere of life;</p> <p>1.7. victim of human trafficking, who has been abducted, hidden, transported or accepted by force for the purpose of exploitation, even if none means of threat or use of force, coercion, fraud, lying or similar form have been used similar regardless of whether or not the child gave his consent voluntarily or through fraud and deception.</p>	<p>norme, uključujući i dete mlađe od krivične odgovornosti;</p> <p>1.4. čiji razvoj je ometan porodičnim prilikama, čiji roditelji nisu u mogućnosti da mu obezbede normalne uslove za fizički, psihički i emocionalni razvoj, kao ni pravilno obrazovanje;</p> <p>1.5. sa ograničenim sposobnostima;</p> <p>1.6. žrtva porodičnog, rodno zasnovanog nasilja i drugih oblika nasilja, žrtva fizičkog, psihičkog ili seksualnog nasilja i koja je pretrpela fizičku, psihičku štetu ili povredu svojih prava i sloboda, po principu ravnopravnosti u oblasti javni ili privatni život;</p> <p>1.7. žrtva trgovine ljudima, koja je oteta, sakrivena, transportovana ili nasilno prihvaćena u svrhu eksploatacije, i ako nije korišćena nikakva sredstva pretnje ili upotrebe sile, prinude, prevare, laži ili oblika prinude, bez obzira da li ili nije dete dalo pristanak dobrovoljno ili putem prevare i obmane;</p>
---	--	---

<p>1.8.viktimë e keqpërdorimit të substancave narkotike, psiko - aktive dhe të formave tjera të varësisë, të cilat për shkak të varësisë, të ndikimeve negative sociale dhe të çrregullimeve e dëmton dhe rrezikon shëndetin dhe jetën e tij;</p> <p>1.9. me shtetësi të Republikës së Kosovës dhe fëmija i huaj që është pa shoqërues të moshës madhore, të cilët para hyrjes në Republikën e Kosovës gjenden pa përcjellje të prindërve apo të kujdestarit ligjor, ose ai fëmijë i cili mbetet pa përcjellje të prindërve, pas hyrje në territorin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.10. të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e përkujdesjes sociale për shkak të varfërisë, ikjes, refugjatë, gjendjes së luftës, vuajtjes së migrimit të detyrueshëm, vdekjes së një apo më shumë anëtarëve të familjes, kthimit nga shërimi, lirimi nga institucioni apo nga rrethanat e tjera të paparashikuara.</p>	<p>1.8. victim of misuse of narcotic, psycho-active substances and other forms of addiction, which, due to addiction, negative social influences and disorders, damages and endangers his health and life;</p> <p>1.9. with citizenship of the Republic of Kosovo and a foreign child who does not have an accompanying adult, who before entering the Republic of Kosovo are unaccompanied by their parents or legal guardian, or a child who remains unaccompanied by their parents, after entering the territory of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.10. who, due to special circumstances, needs an appropriate form of social care due to poverty, flight, refugee, state of war, suffering from forced migration, death of one or more family members, return from recovery, release from institution or from other unforeseen circumstances.</p>	<p>1.8. žrtva zloupotrebe opojnih droga, psihoaktivnih supstanci i drugih oblika zavisnosti, koja usled zavisnosti, negativnih društvenih uticaja i poremećaja šteti i ugrožava njegovo zdravlje i život;</p> <p>1.9. sa državljanstvom Republike Kosovo i dete strance koje je punoletno bez pratnje, koje je pre ulaska u Republiku Kosovo bez pratnje roditelja ili zakonskog staratelja, ili ono dete koje ostaje bez pratnje roditelja, nakon ulaska na teritoriju Republike Kosovo;</p> <p>1.10. kome je zbog posebnih okolnosti neophodan odgovarajući oblik socijalne zaštite zbog siromaštva, bekstva, izbeglištva, ratnog stanja, prinudne migracije, smrti jednog ili više članova porodice, povratka sa oporavka, izlaska iz institucije ili drugih nepredviđenih okolnosti.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Personi madhor dhe i moshuar përfitues i shërbimeve sociale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Adult and elderly beneficiary of social services</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Odrasli i stariji korisnici socijalnih usluga</b></p>
<p>1. Me person madhor dhe i moshuar përfitues i shërbimeve sociale përfshinë personin:</p> <p>1.1. me aftësi të kufizuar mendore, intelektuale apo shqisore me dëmtime afatgjata, pa kujdes familjar;</p> <p>1.2. i cili për shkak të paaftësisë për të gjykuar, është tërësisht ose pjesërisht i paaftë të kujdeset për të drejtat dhe interesat e tij;</p> <p>1.3. që me veprimet e veta të ashpra i rrezikon të drejtat dhe interesat e tij ose të drejtat dhe interesat e personave të tjerë për shkak të sëmundjes së diagnostifikuar, paaftësisë për të gjykuar, ngecjes në zhvillimin psikik apo keqpërdorimit të alkoolit ose të mjeteve narkotike;</p> <p>1.4. materialisht i pasiguruar, përkatësisht personi në gjendje të varfërisë i cili është kualifikuar për kompensimin minimal të garantuar;</p> <p>1.5. i moshës mbi 65 vjeç pa përkujdesje familjare, i cili për shkak të</p>	<p>1. Adult and elderly beneficiary of social services includes a person:</p> <p>1.1. with mental, intellectual or sensory disabilities with long-term impairment, without family care;</p> <p>1.2. who, due to incapacity to judge, is totally or partially unable to take care of his rights and interests;</p> <p>1.3. who, with his harsh actions, endangers his rights and interests or the rights and interests of other persons due to diagnosed illness, incapacity to judge, retardation in psychic development or misuse of alcohol or narcotics;</p> <p>1.4. who is materially insecure, namely the person in a state of poverty who has qualified for the guaranteed minimum compensation;</p> <p>1.5. aged over 65 without family care, who due to permanent changes in the</p>	<p>1. Odrasli i stariji korisnik socijalnih usluga obuhvata lice:</p> <p>1.1. dugotrajnim fizičkim, mentalnim i intelektualnim ili čulne ograničenjem sposobnosti bez porodične nege;</p> <p>1.2. koji je zbog nesposobnosti za rasuđivanje potpuno ili delimično nesposoban da se stara o svojim pravima i interesima;</p> <p>1.3. koji svojim grubim postupcima ugrožava svoja prava i interese ili prava i interese drugih lica zbog dijagnostikovane bolesti, nesposobnosti za rasuđivanje, zaostajanja u psihičkom razvoju ili zloupotrebe alkohola ili opojnih droga;</p> <p>1.4. materijalno neosigurani, odnosno lice u stanju siromaštva koje je kvalifikovano za garantovanu minimalnu naknadu;</p> <p>1.5. stariji od 65 godina bez porodičnog staranja, koji zbog trajnih promena</p>

<p>ndryshimeve të përhershme në gjendjen psiko-sociale apo shëndetësore nuk mund t'i plotësojë nevojat themelore jetësore dhe i cili nuk ka anëtar të familjes as të afërm të cilët me ligj janë të detyruar të përkujdesen, apo për arsye të caktuara nuk kanë mundësi t'a kryejnë detyrimin e përkujdesjes;</p> <p>1.6. me aftësi të kufizuar dhe i lënë pas dore;</p> <p>1.7. me aftësi të kufizuar dhe i keqtrajtuar;</p> <p>1.8. me aftësi të kufizuar dhe i pa shoqëruar si përgjatë migrimit, zhvendosjes si pasojë e luftërave dhe tërmeteve;</p> <p>1.9. me aftësi të kufizuar të cilëve për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e kujdesit social;</p> <p>1.10. me aftësi të kufizuar, i cili për shkak të ndryshimeve të përhershme në gjendjen psiko-sociale apo shëndetësore nuk mund t'i plotësojë nevojat themelore jetësore dhe i cili nuk ka anëtar të familjes as të afërm të cilët me ligj janë të detyruar të përkujdesen, apo për arsye të caktuara nuk kanë</p>	<p>psycho-social or health condition cannot meet the basic needs of life and who has no family member or relatives who are obliged by law to take care of them, or for certain reasons they are unable to fulfil the duty of care;</p> <p>1.6. disabled and neglected;</p> <p>1.7. disabled and abused;</p> <p>1.8. disabled and unaccompanied as (during migration, displacement as a result of wars and earthquakes);</p> <p>1.9. with disabilities who due to special circumstances, need an appropriate form of social care;</p> <p>1.10. with disabilities, who due to permanent changes in the psycho-social or health condition cannot meet the basic needs of life and who does not have a family member or relatives who are obliged by law to take care of them, or for certain reasons they are unable to fulfill the duty of care;</p>	<p>psiko-socijalnog ili zdravstvenog stanja ne može da podmiri osnovne životne potrebe i koji nema člana porodice ili srodnika koji je zakonski prinuđen da se stara, ili iz određenih razloga nije sposoban da obavlja dužnost nege;</p> <p>1.6. sa ograničenim sposobnostima i zapušteni;</p> <p>1.7. sa ograničenim sposobnostima i zlostavljani;</p> <p>1.8. sa ograničenim sposobnostima i bez pratnje kao (tokom migracije, raseljavanja kao posledica ratova i zemljotresa);</p> <p>1.9. sa ograničenim sposobnostima kojima je zbog posebnih okolnosti potreban odgovarajući oblik socijalne zaštite;</p> <p>1.10. sa ograničenim sposobnostima, koji zbog trajnih promena psiko-socijalnog ili zdravstvenog stanja ne mogu da zadovolje osnovne životne potrebe i koji nemaju člana porodice ili srodnike koji su po zakonu obavezni da se o njima staraju, ili su iz određenih</p>
--	--	--

<p>mundësi t'a kryejnë detyrimin e përkujdesjes;</p> <p>1.11. me sjellje negative shoqërore i cili nuk orientohet nga puna, por drejt bredhjes, kërkimit të lëmshës, prostitucionit dhe formave tjera negative të sjelljes shoqërore;</p> <p>1.12. viktimë e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore apo i formave tjera të dhunës të cilit i është shkaktuar dëmtim fizik, mendor, seksual apo ekonomik ose vuajtje, të cilat seriozisht e pengojnë personin që të gëzojë të drejtat dhe liritë e tij, sipas parimit të barazisë në sferën e jetës publike dhe private;</p> <p>1.13. viktimë e trafikimit me njerëz, i cili është kidnapuar, fshehur, me dhunë është transportuar apo është marrë me anë të kërcënimit ose me përdorimin e forcës, apo me mashtrim dhe me forma tjera të detyrimit apo të mashtrimit.</p> <p>1.14. viktimë e keqpërdorimit të mjeteve narkotike, psiko-aktive dhe të formave tjera të varësisë të cilat e kanë sjellë në gjendje të nevojës sociale.</p> <p>1.15. i pastrehë, i cili nuk ka vendbanim as mjete me të cilat do të kishte</p>	<p>1.11. with negative social behavior which is not oriented towards work, but towards wandering, begging, prostitution and other negative forms of social behavior;</p> <p>1.12. a victim of domestic violence, gender-based violence or other forms of violence who has suffered physical, mental, sexual or economic damage or suffering, which seriously prevents the person from enjoying his rights and freedoms, according to the principle of equality in the public and private sphere of life;</p> <p>1.13. a victim of human trafficking, who has been kidnapped, hidden, forcibly transported or taken by threat or use of force, or by fraud and other forms of coercion or fraud.</p> <p>1.14. victim of the misuse of narcotics, psycho-active and other forms of addiction which have brought him to a state of social need.</p> <p>1.15. homeless person, who does not have a place of residence or the means</p>	<p>razloga nesposoban da ispuni dužnost nege;</p> <p>1.11. sa negativnim društvenim ponašanjem koje nije orijentisano na rad, već na lutanje, prosjačenje, prostituciju i druge negativne oblike društvenog ponašanja;</p> <p>1.12. žrtva nasilja u porodici, rodno zasnovanog nasilja ili drugih oblika nasilja koja je pretrpela fizičku, psihičku, seksualnu ili ekonomsku štetu ili patnju, koja ozbiljno onemogućava lice da uživa svoja prava i slobode, po principu ravnopravnosti u oblasti javnog i privatnog života;</p> <p>1.13. žrtva trgovine ljudima, koja je kidnapovana, sakrivena, prisilno transportovana ili odvedena pretnjom ili upotrebom sile, ili prevarom i drugim oblicima prinude ili prevare.</p> <p>1.14. žrtva zloupotrebe opojnih droga, psihoaktivnih i drugih oblika zavisnosti koji su ga doveli u stanje socijalne potrebe.</p> <p>1.15. beskućnik, koji nema prebivalište niti sredstva kojima bi mogao da</p>
--	--	--

<p>mundësi të sigurate banimin, dhe përkohësisht është vendosur në vendin e caktuar për pranim ose qëndron në vendet publike apo në vendet e tjera të cilat nuk janë të destinuara për banim;</p> <p>1.16. të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e përkujdesjes sociale për shkak të varfërisë, fatkeqësive elementare, ikjes, gjendjes së luftës, migrimit të përjetuar të detyrueshëm, vdekjes së njërit apo të më shumë anëtarëve të familjes, kthimit nga shërimi, lëshimi nga institucioni apo i rrethanave tjera të paparashikueshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI V PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE PUBLIKE, PRIVATE DHE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 32 Roli i Ministrisë</b></p> <p>1. Zhvillon dhe zbaton politikat për shërbime sociale dhe familjare si dhe mbrojtje për fëmijët;</p>	<p>with which he would be able to provide housing, and is temporarily located in the place designated for reception or stays in public places or in other places that are not intended for residence;</p> <p>1.16. who, due to special circumstances, needs an appropriate form of social care due to poverty, natural disasters, flight, state of war, experienced forced migration, death of one or more family members, return from recovery, release from the institution or other unforeseen circumstances.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER V RESPONSIBILITIES OF PUBLIC, PRIVATE INSTITUTIONS AND NON- GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 32 Role of the Ministry</b></p> <p>1. Develops and implements policies on social and family services as well as protection for children;</p>	<p>obezbedi smeštaj, a privremeno se nalazi u mestu određenom za prihvat ili boravi na javnim mestima ili na drugim mestima koja nisu predviđena za boravak;</p> <p>1.16. kome je zbog posebnih okolnosti potreban odgovarajući vid socijalne zaštite zbog siromaštva, elementarnih nepogoda, bekstva, ratnog stanja, doživljene prisilne migracije, smrti jednog ili više članova porodice, povratka sa oporavka, otpusta iz institucije ili drugih nepredviđenih okolnosti.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE V NADLEŽNOSTI JAVNIH, PRIVATNIH INSTITUCIJA I NEVLADINIH ORGANIZACIJA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 32 Uloga Ministarstva</b></p> <p>1. Razvija i sprovodi politike socijalnih i porodičnih usluga, kao i zaštite dece;</p>
---	--	--

<p>2. Zhvillon ngritjen e burimeve njerëzore të këshillimit për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare;</p> <p>3.Licencon ofruesit individual dhe joqeveritar të shërbimeve sociale dhe është përgjegjëse për krijimin e institucioneve të kujdesit sociale dhe rezidencial për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.</p> <p>4.Harton dhe është përgjegjëse për përgatitjen e standardeve minimale dhe Kodit Etik për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare;</p> <p>5.Inspekton dhe monitoron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga institucionet e sektorit publik, organizatat joqeveritare dhe ofruesit privat të licencuar.</p>	<p>2. Performs the development of human resources of counseling for professionals of social and family services;</p> <p>3.Licenses individual and non-governmental providers of social services and is responsible for setting up social and residential care institutions for the provision of social and family services.</p> <p>4. Drafts and is responsible for the preparation of minimum standards and the Code of Ethics for social and family service providers;</p> <p>5.Inspects and monitors the provision of social and family services by public sector institutions, non-governmental organizations and licensed private providers;</p>	<p>2.Razvija razvoj ljudskih resursa savetovališta za profesionalce socijalnih i porodičnih službi;</p> <p>3.Licencira pojedinačne i nevladine pružaoce socijalnih usluga i odgovorna je za osnivanje institucije socijalne i stambene zaštite za pružanje socijalnih i porodičnih usluga.</p> <p>4. Izrađuje i odgovoran je za pripremu minimalnih standarda i Etičkog kodeksa za pružaoce socijalnih i porodičnih usluga;</p> <p>5. Proverava i prati pružanje socijalnih i porodičnih usluga od strane institucija javnog sektora, nevladinih organizacija i licenciranih privatnih pružalaca;</p>
<p><b>Neni 33</b> <b>Roli i komunës</b></p>	<p><b>Article 33</b> <b>Role of the Municipality</b></p>	<p><b>Član 33</b> <b>Uloga Opštine</b></p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 60</b> <b>Strehimoret</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 60</b> <b>Shelters</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 60</b> <b>Prihvatilišta</b></p>
<p>1. Ministria, komuna, organizatat joqeveritare dhe personat fizik e juridik mund të themelojnë strehimore me qëllim të sigurimit të strehimit, mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimeve të përkohshme për fëmijën pa kujdes prindëror, viktimën e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, apo edhe ndonjë formë tjetër të dhunës dhe mbrojtjes të përcaktuar me legjislacion</p> <p>2. Komuna, organizata joqeveritare, personat fizik apo juridik nuk mund të themelojë strehimore për njerëzit në nevojë sociale pa lejen e Ministrisë.</p> <p>3. Strehimoret ofrojnë strehim të sigurtë, shërbime për mbrojtjen, rehabilitimin, riintegrimin dhe ofrimin e mbështetjes së specializuar për viktimën e dhunës nga paragrafi 1 i këtij neni, duke ua përshtatur nevojave të tyre specifike.</p> <p>4. Shërbimet e specializuara përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këshillimin psikologjik, kujdesin shëndetësor dhe këshillim juridik.</p> <p>5. Strehimoret bashkëpunojnë me institucionet nga sistemi social, psiko-social,</p>	<p>1. Ministry, municipality, non-governmental organizations and natural and legal persons can establish shelters for the purpose of providing shelter, protection and providing temporary services for children without parental care, victims of domestic violence, human trafficking, or any other form of violence and protection defined by legislation</p> <p>2. Municipality, non-governmental organization, natural or legal persons cannot establish shelters for people in social need without the permission of the Ministry.</p> <p>3. The shelters offer safe housing, services for protection, rehabilitation, reintegration and provision of specialized support for the victim of violence from paragraph 1 of this Article, adapting to their specific needs.</p> <p>4. Specialized services include, but are not limited to, psychological counseling, health care, and legal counseling.</p> <p>5. Shelters cooperate with institutions from the social, psycho-social, education and</p>	<p>1. Ministarstva, opštine, nevladine organizacije i fizička i pravna lica mogu osnivati prihvatilište radi pružanja smeštaja, zaštite i pružanja privremenih usluga deci bez roditeljskog staranja, žrtvama nasilja u porodici, trgovine ljudima ili bilo kog drugog oblika nasilja i zaštite definisano zakonodavstvom.</p> <p>2. Opština, nevladina organizacija, fizička ili pravna lica ne mogu osnivati prihvatilišta za lica u stanju socijalne potrebe bez dozvole Ministarstva.</p> <p>3. Prihvatilišta nude bezbedan smeštaj, usluge zaštite, rehabilitacije, reintegracije i pružanje specijalizovane podrške žrtvi nasilja iz stava 1. ovog člana, prilagođavajući se njihovim specifičnim potrebama.</p> <p>4. Specijalizovane usluge uključuju, ali nisu ograničene na, psihološko savetovanje, zdravstvenu zaštitu i pravno savetovanje.</p> <p>5. Prihvatilišta sarađuju sa institucijama iz socijalnog, psihosocijalnog, obrazovnog i</p>

<p>arsimit dhe shëndetësisë, policisë, prokurorisë dhe gjykatave.</p> <p>6. Puna në strehimore realizohet sipas parimit të urgjencës dhe vendosjes së përkohshme.</p> <p>7. Të gjitha masat duhet të ndërmerren që viktimat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni të kthehen në familjet e tyre apo në forma të tjera të mbrojtjes, në përputhje me interesin më të mirë të viktimës, duke iu siguruar një riintegrim të sigurtë dhe të qëndrueshëm.</p> <p>8. Në procedurën e strehimit, puna dhe masat e tjera në strehimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>9. Themelimi, organizimi dhe funksionimi i Shëpive për mbrojtjen e fëmijëve përcaktohen me Ligjin përkatës për mbrojtjen e fëmijës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 61</b> <b>Qendrat e Kujdesit Ditor</b></p> <p>1. Për përkujdesin ditor dhe shërbime ditore në komunitet themelohen Qendrat e Kujdesit Ditor.</p>	<p>health systems, police, prosecution and courts.</p> <p>6. Work in shelters is carried out according to the principle of emergency and temporary placement.</p> <p>7. All measures must be taken for the victims defined in paragraph 1 of this Article to return to their families or to other forms of protection, in accordance with the best interest of the victim, ensuring a safe and stable reintegration.</p> <p>8. In the sheltering procedure, work and other measures in shelters, the provisions of the relevant legislation in force are appropriately applied.</p> <p>9. The establishment, organization and operation of Child Protection Houses are determined by the relevant Law on Child Protection.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 61</b> <b>Day Care Centers</b></p> <p>1. Day Care Centers are established for day care and day services in the community.</p>	<p>zdravstvenog sistema, policijom, tužilaštvom i sudovima.</p> <p>6. Rad u prihvatilišta odvija se po principu hitnog i privremenog smeštaja.</p> <p>7. Moraju se preduzeti sve mere da se žrtve iz stava 1. ovog člana vrate svojim porodicama ili drugim oblicima zaštite, u skladu sa najboljim interesom žrtve, obezbeđujući bezbednu reintegraciju i stabilno.</p> <p>8. U postupku stambenog zbrinjavanja, radu i drugim merama u prihvatilište na odgovarajući se način primenjuju odredbe važećeg zakona.</p> <p>9. Osnivanje, organizacija i funkcionisanje centara dečije zaštite utvrđuju se odgovarajućim Zakonom o Zaštiti Deteta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 61</b> <b>Dnevni Centri za dnevni boravak</b></p> <p>1. Dnevni centri se osnivaju za dnevni boravak i dnevne usluge u zajednici.</p>
--	--	--

<p>2. Qendrën e Kujdesit Ditor nga paragrafi 1 të këtij neni, mund ta themelojë Ministria, komuna, organizatat joqeveritare, personi fizik apo juridik në pajtim me ligjin.</p> <p>3. Qendrat e Kujdesit Ditor për përkujdesjen ditore dhe shërbime sociale, janë:</p> <p>3.1. Qendra e Kujdesit Ditor për fëmijë;</p> <p>3.2. Qendra e Kujdesit Ditor për të rritur dhe të moshuar;</p> <p>3.3. Qendra për shërbime sociale të specializuara.</p> <p>4. Organizimi dhe fushëveprimi i Qendrave për Kujdes ditor rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.</p>	<p>2. The Day Care Center from paragraph 1 of this Article can be established by the Ministry, municipality, non-governmental organizations, natural or legal person in accordance with the law.</p> <p>3. Day Care Centers for day care and social services are:</p> <p>3.1. Day care center for children;</p> <p>3.2. Day care center for adults and the elderly;</p> <p>3.3. Center for specialized social services.</p> <p>4. The organization and scope of Day Care Centers is regulated by a sub-legal act proposed by the Ministry and approved by the Government.</p>	<p>2. Dnevni boravak iz stava 1. ovog člana može osnovati Ministarstvo, opština, nevladine organizacije, fizičko ili pravno lice u skladu sa zakonom.</p> <p>3. Dnevni centri za dnevni boravak i socijalne usluge su:</p> <p>3.1. Dnevni boravak za decu;</p> <p>3.2. Dnevni boravak za odrasle i stare osobe ;</p> <p>3.3. Centar za specijalizovane socijalne usluge.</p> <p>4. Organizacija i delokrug rada dnevnih centara uređuje se podzakonskim aktom koji predlaže Ministarstvo, a usvaja Vlada.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 62</b> <b>Qendra për pranim</b></p> <p>1. Për përkujdesje për periudhë të shkurtër për fëmijët e braktisur, fëmijët me ç'rregullime në sjellje, personat e rritur me sjellje shoqërore negative, shtatzënat dhe nënat me fëmijë deri në një vit të jetës së fëmijës, të cilëve për shkak të pasigurisë materiale, të çështjes banesore të pazgjidhur, të marrëdhënieve familjare të çrregulluara,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 62</b> <b>Reception Center</b></p> <p>1. For short-term care for abandoned children, children with behavioral disorders, adults with negative social behavior, pregnant women and mothers with children up to one year of the child's life, who, due to financial insecurity, unresolved housing issue, disordered family relations, and similar situations, need temporary care, as well as</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 62</b> <b>Prihvatni Centar</b></p> <p>1. Za kratkotrajno zbrinjavanje napuštene dece, dece sa smetnjama u ponašanju, odraslih sa negativnim socijalnim ponašanjem, trudnica i majki sa decom do godinu dana života deteta, koje zbog finansijske nesigurnosti, nerešenog stambenog pitanja, poremećenih porodičnih odnosa, i sličnim situacijama, kojima je</p>

<p>dhe të situatave të ngjashme, nevojitet përkujdesi i përkohshëm, si dhe personat e tjerë të cilët kanë nevojë për përkujdesje sociale urgjente, Ministria themelon Qendrën për pranim.</p> <p>2. Selia e Qendrës për Pranim është në Prishtinë.</p> <p>3. Në qendrën për pranim kryhet trajtimi diagnostiko-observator, si dhe ofrimi i masave të domosdoshme të mbrojtjes, si dhe aplikimi i masave shëndetësore-higjienike, edukativo-arsimore dhe masat psiko-sociale për plotësimin e nevojave ekzistenciale dhe të nevojave tjera të shfrytëzuesve.</p> <p>4. Qëndrimi në qendrën pranuese mund të zgjasë deri në tre muaj, ndërsa vetëm në situatat e veçanta mund të zgjasë deri në gjashtë muaj, nëse procedura e gjetjes së formës adekuate të përkujdesjes e kërkon këtë.</p> <p>5. Organizimi dhe fushëveprimi i Qendras për Pranim rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.</p>	<p>other people who need urgent social care, the Ministry establishes the Reception Center.</p> <p>2. The seat of the Reception Center is in Prishtina.</p> <p>3. In the Reception Center is performed the diagnostic-observational treatment, and the provision of necessary protection measures, as well as the application of health-hygienic, educational and psycho-social measures to meet the existential and other needs of users .</p> <p>4. The stay in the reception center can last up to three months, while only in specific situations it can last up to six months, if the procedure of finding the adequate form of care requires it.</p> <p>5. The organization and scope of the Reception Center is regulated by a sub-legal act proposed by the Ministry and approved by the Government.</p>	<p>potrebno privremeno zbrinjavanje, kao i drugim licima kojima je potrebna hitna socijalna zaštita, Ministarstvo osniva Prihvatni Centar.</p> <p>2. Sedište Prihvatnog Centra je u Prištini.</p> <p>3. U prihvatnom centru se obavlja dijagnostičko-opservacioni tretman, pružanje neophodnih mera zaštite, kao i primena zdravstveno-higijenskih, vaspitno-obrazovani i psihosocijalnih mera za zadovoljavanje egzistencijalnih potreba i drugih potreba stanovništva korisnika.</p> <p>4. Boravak u prihvatnom centru može trajati do tri meseca, dok samo u posebnim situacijama može trajati do šest meseci, ako to zahteva procedura pronalaženja adekvatnog oblika zbrinjavanja.</p> <p>5. Organizacija i delokrug Prihvatnog centra uređuje se podzakonskim aktom koji predlaže Ministarstvo i usvaja Vlada.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 63</b> <b>Strehimi në institucion e përkujdesjes</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 63</b> <b>Sheltering (housing) in a care institution</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 63</b> <b>Smeštaj u starateljskoj instituciji</b></p>
<p>1. Pranimi i personit në institucion dhe lëshimi i tyre kryhet në mënyrën e caktuar me aktin e përgjithshëm të institucionit dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria.</p> <p>2. Institucioni është i obliguar të pranojë në strehim personat të cilët i dërgon qendra për punë sociale apo organi tjetër kompetent.</p> <p>3. Përfundimisht nga paragrafi 2 të këtij neni, institucioni mund të refuzojë pranimin e personave të dërguar në rast se kapacitetet plotësohen dhe në rastin kur për shkak të veprimtarisë së saj, nuk ka mundësi që të ofrojë shërbime përkatëse të përfituesve,</p> <p>4. Në rast të refuzimit, Institucioni i Përkujdesjes ofron përgjigje të arsyetuar me shkrim.</p> <p>5. Institucioni i përkujdesjes në të cilin është vendos fëmija, personi i rritur dhe i moshuar me vendim të Organit të Kujdestarisë, e informon Organin e Kujdestarisë për të gjitha çështjet e rëndësishme për jetën, shëndetin, edukimin, arsimimin e personit nën përkujdesje, dhe lëshimin e mundshëm nga institucioni.</p>	<p>1. The admission of the person in the institution and their release is carried out in the manner determined by the general act of the institution and the procedures determined by the Ministry.</p> <p>2. The institution is obliged to accept in sheltering the persons sent by the center for social work or other competent body.</p> <p>3. Notwithstanding paragraph 2 of this article, the institution can refuse to accept the sent persons in case the capacities are filled and in the case when due to its activity, it is not possible to offer relevant services to the beneficiaries,</p> <p>4. In case of refusal, the Care Institution provides a reasoned response in writing.</p> <p>5. The care institution in which the child, or the adult and elderly person is placed by decision of the Guardianship Body, informs the Guardianship Body about all matters important for the life, health, education, schooling of the person under care, and possible release from the institution.</p>	<p>1. Prijem osoba u instituciji i otpuštanje vrši se na način utvrđen opštim aktom institucije i postupcima koje utvrđuje Ministarstvo.</p> <p>2. Institucija je u obavezi da da primi na smeštaj lica upućena od centra za socijalni rad ili drugog nadležnog organa.</p> <p>3. Izuzev stava 2 ovog člana, institucija može odbiti prijem upućenih lica u slučaju da su kapaciteti popunjeni i u slučaju kada zbog njene delatnosti nije moguće ponuditi relevantne usluge korisnicima,</p> <p>4. U slučaju odbijanja, starateljska institucija daje obrazložen odgovor u pisanoj formi.</p> <p>5. Institucija za negu u koju je dete, odnosno odraslo i staro lice smešteno odlukom organa starateljstva, obaveštava organ starateljstva o svim pitanjima od značaja za život, zdravlje, obrazovanje, obrazovanje lica na staranju ,i eventualno otpuštanje iz institucije.</p>

<p>6.Për strehim në të gjitha format e strehimit rezidencial vendos Qendra për Punë Sociale në territorin e të cilës personi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.</p> <p>7.Qendra për Punë Sociale e cila e ka vendosur personin në cilëndo formë të përkujdesjes, kërkon raport dhe përcjellë ofrimin e përkujdesjes në strehim rezidencial.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 64</b> <b>Pushimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve për strehim rezidencial</b></p> <p>Themeluesit e shërbimeve për strehim janë të obliguar që së paku gjashtë muaj para nxjerrjes së vendimit për pushimin e veprimtarisë së shërbimit, ta njoftojnë Qendrën për Punë Sociale, Ministrinë si dhe përfituesit, përkatësisht përfaqësuesit e tyre ligjor.</p>	<p>6. For housing in all forms of residential care (housing), the Center for Social Work on the territory of which the person has the place of residence or temporary residence, shall decide.</p> <p>7. The Center for Social Work, which has placed the person in any form of care, shall request a report and follow up on the provision of care in residential housing.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 64</b> <b>Cessation of the activity of residential care (housing) service providers</b></p> <p>The founders of housing services are obliged to notify the Center for Social Work, the Ministry as well as the beneficiaries, respectively their legal representatives, at least six months before issuing the decision on cessation of the activity of the service.</p>	<p>6. Za smeštanje u svim oblicima stambenog smeštaja Centar za socijalni rad odlučuje na čijoj teritoriji lice ima prebivalište.</p> <p>7. Centar za socijalni rad, koji je osobu smestio u bilo koji oblik zbrinjavanja, traži izveštaj i prati pružanje nege u stambenim objektima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 64</b> <b>Obustava delatnosti pružalaca usluga stambenog smeštaja</b></p> <p>Osnivači stambenih usluga u obavezi su da obaveste Centar za socijalni rad, Ministarstvo kao i korisnike, odnosno njihove zakonske zastupnike, najmanje šest meseci pre donošenja rešenja o prestanku uslužne delatnosti.</p>
--	---	--



**KAPITULLI VIII  
PUNONJËSI PROFESIONAL NË  
SHËRBIMET SOCIALE DHE  
FAMILJARE**

**Neni 65**

**Punonjësit profesional në institucionin e  
shërbimit social dhe ofruesit e  
shërbimeve sociale**

1. Në institucionet e shërbimeve sociale, përkatësisht tek ofruesi i shërbimit social, punët profesionale i kryen punonjësi social, juristi, psikologu, sociologu, pedagogu dhe personat e tjerë në pajtim me ligjin.

2. Profesionistët nga paragrafi 1 i këtij neni kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive, të pavarur, të paanshme dhe duhet t'u përmbahen parimeve të fshehtësisë profesionale lidhur me informatat e mbledhura, të gjeturat tjera për të cilat mësojnë gjatë kryerjes së detyrës dhe praktikave jo diskriminuese, në pajtimkodin e etikës me ligjin dhe aktet nënligjore përkatëse.

3. Punët profesionale në shërbimin social në Qendrën për Punë Sociale i kryejnë

**CHAPTER VIII  
PROFESSIONAL WORKERS IN  
SOCIAL AND FAMILY SERVICES**

**Article 65**

**Professional workers in social service  
institutions and social service providers**

1. In social service institutions, namely at the social service provider, professional work is performed by the social worker, legal practitioner, psychologist, sociologist, pedagogue and other persons in accordance with the law.

2. The professionals from paragraph 1 of this Article perform their duties objectively, independently, impartially and must adhere to the principles of professional secrecy regarding the information collected, other findings they learn about during the performance of their duties and non-discriminatory practices, in accordance with the code of ethics, the law and relevant sub-legal acts.

3. Professional work in social service at the Center for Social Work is carried out by the

**POGLAVLJE VIII  
STRUČNI ZAPOSLENIK U  
SOCIJALNIM I PORODIČNIM  
USLUGAMA**

**Član 65**

**Stručni zaposleni u institucijama  
socijalne službe i pružaoci socijalnih  
usluga**

1. U institucijama socijalnih usluga, odnosno kod pružaoca socijalne usluge, stručne poslove obavlja socijalni zaposlenik, pravnik, psiholog, sociolog, pedagog i druga lica u skladu sa zakonom.

2. Profesionalci iz stava 1. ovog člana obavljaju svoje dužnosti na objektivan način, nezavisano, nepristrasano i trebaju se pridržavati načelima profesionalne tajne u vezi sa prikupljenim informacijama, drugim nalazima za koje saznaju tokom obavljanja dužnosti i nediskriminatornim praksama, u skladu sa etičkim kodeksom sa zakonom i odgovarajućim podzakonskim aktima.

3. Stručne radove u socijalnoj službi u Centru za socijalni rad obavljaju socijalni zaposleni, pravnik, psiholog, sociolog i pedagog.

<p>punonjësi social, juristi, psikologu, sociologu dhe pedagogu.</p> <p>4. Punonjësit profesional në institucionet e tjera të shërbimeve dhe tek ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale, punët profesionale i kryen përveç punonjësve nga paragrafi 3 i këtij neni i kryejnë edhe logopedi, infermierja, fizioterapeuti dhe edukatori, ndërsa mund t'i kryejnë edhe punëtorët e tjerë profesional të arsimit përkatës, varësisht nga institucioni për shërbime sociale apo lloji tjetër i shërbimeve sociale të ofruesit tjetër.</p> <p>5. Punonjësit profesional janë të obliguar që të ruajnë si fshehtësi të gjitha njohuritë për jetën personale dhe familjare të përfituesit, ndërsa ruajtja e fshehtësisë profesionale i obligon edhe punëtorët e tjerë të institucioneve të shërbimeve sociale dhe të ofruesve tjerë të shërbimeve.</p> <p>6. Mosrespektimi i konfidencialitetit nga zyrtari përgjegjës dhe çdo personi tjetër i cili pranon raportime në interes publik do të konsiderohet si shkelje e detyrave të punës.</p> <p>7. Shërbimet sociale dhe familjare për të mirën e komunitetit mund të ofrohen edhe vullnetarët.</p>	<p>social worker, legal practitioner, psychologist, sociologist and pedagogue.</p> <p>4. For professional employees in other service institutions and other social service providers, the professional work, in addition to the employees from paragraph 3 of this Article is also performed by speech therapist, nurse, physiotherapist and educator, while it can also be performed by other professionals workers with relevant education, depending on the social services institution or other type of social services of other provider.</p> <p>5. Professional workers are obliged to keep confidential all knowledge about the personal and family life of the beneficiary, while other workers of social service institutions and other service providers are also obliged to maintain professional secrecy.</p> <p>6. Failure to respect confidentiality by the responsible official and any other person who accepts reports in the public interest will be considered a violation of work duties.</p> <p>7. Social and family services for the benefit of the community can also be provided by volunteers.</p>	<p>4. Stručni zaposleni u drugim uslužnim institucijama i drugim pružaocima socijalnih usluga, stručne poslove obavljaju pored zaposlenih iz stava 3. ovog člana i logoped, medicinska sestra, fizioterapeut i vaspitač, dok mogu ih obavljati i drugi stručni radnici odgovarajućeg obrazovanja, u zavisnosti od institucije za socijalne usluge ili druge vrste socijalnih usluga drugog pružaoca.</p> <p>5. Stručni zaposleni obavezni su da čuvaju kao tajnost sva saznanja o ličnom i porodičnom životu korisnika, dok čuvanje stručne tajne obavezuje i druge radnike institucija socijalnih zaštita i drugih pružaoca usluga.</p> <p>6. Nepoštovanje poverljivosti od odgovornog službenika i svakog drugog lica koje prima izveštaje u javnom interesu smatraće se kao povreda radnih dužnosti.</p> <p>7. Socijalne i porodične usluge za dobrobit zajednice mogu pružati i volonteri.</p>
---	---	--

<p>8. Ministri nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e shërbime sociale dhe familjare të cilat i ofrojnë vullnetarët.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 66</b> <b>Përpunimi i të dhënave personale</b></p> <p>Çdo përpunim i të dhënave personale, përfshirë shkëmbimin ose transmetimin e të dhënave personale nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, do të bëhet në pajtim me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 67</b> <b>Aftësimi profesional i punonjësve të shërbimeve sociale</b></p> <p>1. Punonjësit profesional në fushën e shërbimit social kanë të drejtë dhe detyrim që të vijojnë në mënyrë të vazhdueshme aftësimin profesional.</p> <p>2. Institucioni i shërbimit social, përkatësisht ofruesi i shërbimeve sociale është i obliguar që punonjësit profesional t'i sigurojë aftësimin profesional në pajtim me ligjin.</p>	<p>8. The Minister shall issue a sub-legal act for defining the social and family services offered by volunteers.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 66</b> <b>Processing of personal data</b></p> <p>Any processing of personal data, including the exchange or transmission of personal data by social and family service providers, shall be done in accordance with the relevant Law on the Protection of Personal Data.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 67</b> <b>Professional training of social services workers</b></p> <p>1. Professional workers in the field of social service shall have the right and obligation to continuously attend professional training.</p> <p>2. The social service institution, namely the social service provider is obliged to provide the professional employee with professional training in accordance with the law.</p>	<p>8. Ministar donosi podzakonski akt za utvrđivanje socijalnih i porodičnih usluga koje pružaju volonteri.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 66</b> <b>Obrada ličnih podataka</b></p> <p>Svaka obrada ličnih podataka, uključujući razmenu ili prenos ličnih podataka od pružalaca socijalnih i porodičnih usluga, vršiće se u skladu sa odgovarajućim Zakonom o zaštiti ličnih podataka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 67</b> <b>Stručno osposobljavanje zaposlenih socijalnih usluga</b></p> <p>1. Stručni zaposleni u oblasti socijalne usluge imaju pravo i dužnost da slede na kontinuiran način stručno osposobljavanje.</p> <p>2. Institucija socijalne usluge, odnosno pružalac socijalnih usluga obavezan je da stručnom zaposleniku obezbedi stručno osposobljavanje u skladu sa zakonom.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI IX LICENCIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 68 Licencimi</b></p> <p>1. Shërbimet sociale dhe familjare në institucioneve publike, si dhe organizatat joqeveritare dhe personat fizik e juridike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare licencohen nga Ministria.</p> <p>2. Licenca nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare në kohëzgjatje prej një (1) viti, tri (3) vite -apo pesë (5) vite.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 69 Kushtet për dhënien e licencës</b></p> <p>1. Të drejtën në licencë e ka institucioni, përkatësisht ofruesi i shërbimit i cili:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. është regjistruar në pajtim me ligjin;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. i plotëson kushtet e parapara në pikëpamje të hapësirës, infrastrukturës, pajisjeve dhe kuadrit profesional; dhe</p>	<p style="text-align: center;"><b>CHAPTER IX LICENSING OF PROVIDERS OF SOCIAL AND FAMILY SERVICES</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 68 Licencing</b></p> <p>1. Social and family services in public institutions, as well as non-governmental organizations and natural and legal persons for the provision of social and family services are licensed by the Ministry.</p> <p>2. The license from paragraph 1 of this Article is issued to the provider of social and family services for a duration of one (1) year, three (3) years or five (5) years.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 69 Conditions for granting a license</b></p> <p>1. The institution, namely the service provider shall have the right to the license if:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. it is registered in accordance with the law;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. it meets the conditions provided in terms of space, infrastructure, equipment and professional staff; and</p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE IX LICENCIRANJE PRUŽAOCA SOCIJALNIH I PORODIČNIH USLUGA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 68 Licenciranje</b></p> <p>1. Socijalne i porodične usluge u javnim institucijama, kao i nevladine organizacije i fizička i pravna lica za pružanje socijalnih i porodičnih usluga licenciraju se od Ministarstva.</p> <p>2. Licenca iz stava 1. ovog člana izdaje se pružaoцу socijalnih i porodičnih usluga u trajanju od jedne (1) godine, tri (3) godine ili pet (5) godina.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 69 Uslovi za izdavanje licence</b></p> <p>1. Pravo na licencu ima institucija, odnosno pružalac usluge koji:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. je registrovan u skladu sa zakonom;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. ispunjava predviđene uslove u pogledu prostora, infrastrukture, oprema i stručnog osoblja; i</p>
--	--	--

<p>1.3. i plotëson standardet minimale të parapara për ofrimin e shërbimeve sociale për të cilën kërkon dhënien e licencës.</p> <p>2. Licenca mund të përsëritet sipas kërkesës së institucionit dhe ofruesit të shërbimit.</p> <p>3. Për përsëritjen e licencës vlejné kushtet të cilat aplikohen në kohën e paraqitjes së kërkesës për përsëritje. Procedura për përsëritjen e licencës duhet të zhvillohet më së voni tre (3) muaj para skadimit të afatit për të cilën është dhënë licenca.</p> <p>4. Nëse organi kompetent gjatë periudhës për të cilën është dhënë licenca, konstaton se institucioni apo ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare tanimë nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, do të zhvillojë procedurën për pezullimin e licencës.</p> <p>5. Me vendimin për pezullim konstatohen mangësitë në pikëpamje të plotësimin të kushteve sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet afati për evitimin e tyre.</p> <p>6 . Institucioni dhe ofruesi i shërbimit social dhe familjar nuk mund të vazhdojë të ofrojë shërbime për të cilën është pezulluar licenca</p>	<p>1.3. it meets the minimum standards foreseen for the provision of social services for which it requests the granting of a license.</p> <p>2. The license can be renewed at the request of the institution and the service provider.</p> <p>3. For the renewal of the license, the conditions applied at the time of submission of the request for renewal shall apply. The procedure for renewal of the license must take place no later than three (3) months before the expiration of the term for which the license was granted.</p> <p>4. If the competent body, during the period for which the license was granted, finds that the institution or provider of social and family services no longer meets the conditions from paragraph 1 of this Article, it will conduct the procedure for the suspension of the license.</p> <p>5. With the decision on suspension deficiencies are ascertained in terms of meeting the conditions according to paragraph 1 of this Article, and the deadline for their avoidance is determined.</p> <p>6. The institution and social and family service provider cannot continue to provide services for which the license has been</p>	<p>1.3. ispunjava minimalne standarde predviđene za pružanje socijalnih usluga za koje traži izdavanje licence.</p> <p>2. Licenca se može obnoviti/ponoviti prema zahtevu institucije i pružaoca usluge.</p> <p>3. Za obnavljanje licence važe uslovi koji se primenjuju u vreme podnošenja zahteva za obnovu. Postupak za obnavljanje/ponavljanje licence treba se razviti najkasnije tri (3) meseca pre isteka roka za koji je licenca data.</p> <p>4. Ako nadležni organ, tokom perioda za koji je izdata licenca, utvrdi da institucija, ili pružalac socijalnih i porodičnih usluga više ne ispunjava uslove iz stava 1. ovog člana, razvije postupak za suspenziju licencu.</p> <p>5. Odlukom o suspenziji utvrđuju se nedostaci u pogledu ispunjavanja uslova prema stavu 1. ovog člana, utvrđuje se rok za njihovo otklanjanje.</p> <p>6. Institucija i pružalac socijalne i porodične usluge ne može nastaviti pružati usluge za</p>
---	---	---

<p>deri në skadimin e afatit për eliminimin e mangësive.</p> <p>7. Ministri merr vendim për marrjen e licencës së institucionit apo ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare nëse në afatin e përcaktuar nga njësia inspektuese në Ministri nuk i eliminon mangësitë e konstatuara.</p> <p>8. Vendimi i Ministrit për marrjen e licencës është përfundimtar dhe kundër tij mund të iniciohet konflikti administrativ.</p> <p>9.Procedura për dhënien, përsëritjen, pezullimin dhe marrjen e licencës përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.</p>	<p>suspended until the expiration of the deadline for eliminating deficiencies.</p> <p>7. The Minister takes a decision on license revocation of the institution or provider of social and family services if, within the deadline set by the inspection unit at the Ministry, it fails to eliminate the identified deficiencies.</p> <p>8. The decision of the Minister for revoking the license is final and administrative conflict can be initiated against it.</p> <p>9. The procedure for granting, renewal, suspension and revocation of the license is determined by a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>koje je licenca suspendovana do isteka roka za otklanjanje nedostataka.</p> <p>7. Ministar donosi odluku o dobijanju licence institucije ili pružaoca socijalnih i porodičnih usluga ako u roku utvrđenim od inspekcijske jedinice u Ministarstvu ne otkloni utvrđene nedostatke.</p> <p>8. Odluka Ministra za dobijanje licence je konačna i protiv nje se može pokrenuti upravni spor.</p> <p>9. Postupak za davanje, ponavljanje, suspenzije i dobijanje licence se utvrđuje podzakonskim aktom donetim od Ministra.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 70</b> <b>Licencimi i punonjësve profesional për marrjen e licencës</b></p> <p>1. Punonjësi profesional mund të pajiset me licencë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare nëse i plotëson kriteret dhe kushtet e përcaktuara.</p> <p>2.Kriteret dhe kushtet për marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga punonjësit profesionale</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 70</b> <b>Licensing of professional workers for obtaining a license</b></p> <p>1. Professional worker can obtain a license for the exercise of professional activity in the field of social and family services if they fulfill the defined criteria and conditions.</p> <p>2. The criteria and conditions for obtaining a license for the provision of social and family services by professional worker are</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 70</b> <b>Licenciranje stručnih zaposlenih za dobijanje licence</b></p> <p>1. Stručni zaposlenik može se opremiti licencom za vršenje stručne delatnosti u oblasti socijalnih i porodičnih usluga ako ispunjava utvrđene kriterijume i uslove.</p> <p>2. Kriterijumi i uslovi za dobijanje licence za pružanje socijalnih i porodičnih usluga od stručnih zaposlenih utvrđuju se podzakonskim aktom donetim od Ministra.</p>

<p>përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI X MBIKËQYRJA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 71 Mbikëqyrja e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare</b></p> <p>1. Ministria nëpërmjet zyrtarëve të Departamentit përkatës, si dhe Komuna nëpërmjet Qendrës për Punë Sociale, mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve social dhe familjare.</p> <p>2. Për mbikëqyrjen nga paragrafi 1 i këtij neni përpilohet procesverbal.</p> <p>3. Ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare bashkëpunojnë me zyrtarët mbikëqyrës dhe ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme.</p> <p>4. Zyrtari mbikëqyrës jep udhëzime për masat që duhet të ndërmerren për harmonizimin e cilësisë së shërbimeve me standarde profesionale.</p>	<p>determined by a sub-legal act issued by the Minister.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER X SUPERVISION</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 71 Supervision of social and family service providers</b></p> <p>1. The Ministry through the officials of the relevant Department, as well as the Municipality through the Center for Social Work, supervises the provision of social and family services.</p> <p>2. Minutes are drawn up for the supervision from paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. Social and family service providers cooperate with supervisory officials and provide all necessary information.</p> <p>4. The supervisory officer gives instructions on the measures to be taken to align the quality of services with professional standards.</p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE X NADZOR</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 71 Nadzor pružaoca socijalnih i porodičnih usluga</b></p> <p>1. Ministarstvo, preko službenika odgovarajućeg odeljenja, kao i Opština preko Centra za socijalni rad, nadzori pružanje socijalnih i porodičnih usluga.</p> <p>2. O nadzoru iz stava 1. ovog člana sastavlja se zapisnik.</p> <p>3. Pružaoci socijalnih i porodičnih usluga saraduju sa nadzornim službenicima i pružaju sve potrebne informacije.</p> <p>4. Nadzorni službenik daje uputstva za mere koje trebaju preduzeti za usklađivanje kvaliteta usluga sa stručnim standardima.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 72 Inspektimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 72 Inspection</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 72 Inspekcija</b></p>
<p>1. Ministria përmes inspektorëve kryen inspektimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare</p> <p>2. Njësia e inspektimit kryen:</p> <p>2.1. Inspektimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare të përcaktuara me ligj.</p> <p>2.2. Inspektimin e zbatimit të standardeve minimale në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.</p> <p>2.3. Inspektimin e zbatimit të kodit të etikës.</p> <p>2.4. Inspektimin për realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj;</p> <p>2.5. mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe gjobave të shqiptuara, me rastin e mbikëqyrjes së inspektimeve të kryera më parë.</p> <p>2.6. rekomandon marrjen e përgjegjësitë së drejtpërdrejta të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur komuna dështon në ofrimin e</p>	<p>1. The Ministry, through inspectors, performs the inspection of social and family service providers</p> <p>2. The inspection unit performs:</p> <p>2.1. Inspection of the provision of social and family services defined by law.</p> <p>2.2. Inspection of the implementation of minimum standards in the provision of social and family services.</p> <p>2.3. Inspection of the implementation of the code of ethics.</p> <p>2.4. Inspection on the realization of the rights defined by law;</p> <p>2.5. Supervision of the implementation of the imposed measures and fines, in the case of the supervision of the inspections carried out previously.</p> <p>2.6. recommends taking direct responsibility for social and family services in cases where the municipality fails to provide services and implement</p>	<p>1. Ministarstvo, preko inspektora, obavlja inspekciju pružaoca socijalnih i porodičnih usluga</p> <p>2. Jedinica za inspekciju obavlja:</p> <p>2.1. Inspekciju pružanja socijalnih i porodičnih usluga utvrđenih zakonom.</p> <p>2.2. Inspekciju sprovođenja minimalnih standarda u pružanju socijalnih i porodičnih usluga.</p> <p>2.3. Inspekciju sprovođenja etičkog kodeksa.</p> <p>2.4. Inspekciju za realizaciju prava utvrđenih zakonom;</p> <p>2.5. nadzor sprovođenja izrečenih mera i novčanih kazni, u slučaju nadzora inspekcija prethodno obavljenim.</p> <p>2.6. preporučuje preuzimanje direktnih odgovornosti za socijalne i porodične usluge u slučajevima kada opština ne uspe u pružanju usluga i sprovođenju</p>



